



ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2014

“Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë me të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht”

Publikuar nga:

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Blv. Gjergj Fishta, Nr. 10
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel. : 00355 4 2258046
http: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Janar 2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2014

**VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS-KANALIZIME**

JANAR, 2015

Përmbajtja

FJALA HYRËSE	5
1. VEPRIMTARIA VJETORE E ERRU-SË	7
1.1. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË	8
1.2. FORMA ORGANIZATIVE E ERRU-SË	10
1.3. VEPRIMTARIA RREGULLATORE DHE MONITORUESE.....	12
• <i>Licencimi i operatorëve ujësjellës-kanalizime</i>	12
• <i>Tarifat dhe proçesi tarifar</i>	14
• <i>Përballueshmëria e tarifave</i>	19
• <i>Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit</i>	22
• <i>Standardet në sektorin UK</i>	24
1.4. KONSOLIDIMI INSTITUCIONAL	26
• <i>Përmirësimi i instrumenteve rregullatorë</i>	26
• <i>Bashkëpunimi me aktoret në sektor</i>	29
1.5. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E ERRU-SË	31
• <i>Burimet e financimit të veprimtarisë së ERRU-së</i>	31
• <i>Shpenzimet operative</i>	32
• <i>Pagesat rregullatore për vitin 2014</i>	33
1.6. RREGULLIMI PËR VITIN 2015	34
2. GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS-KANALIZIME	35
2.1. FORMA E ADMINISTRIMIT TË SEKTORIT	35
• <i>Organizimi i sektorit UK</i>	35
• <i>Ligji për sektorin UK</i>	36
• <i>Pronësia e asetëve</i>	36
• <i>Llogaridhënia</i>	37
2.2. MBULIMI ME SHËRBIME UJËSJELLËS E KANALIZIME	38
2.3. KOSTOT PËR SHËRBIMET UJËSJELLËS E KANALIZIME	41
2.4. PERFORMANCA E SEKTORIT UK	44
2.5. OBJEKTIVAT RREGULLATORE TË SEKTORIT UK PËR VITIN 2015	48
ANEKSI 1 - APLIKIMET PËR NDRYSHIMIN PËR TARIFA NË VITIN 2014.....	50
ANEKSI 2 - TARIFAT AKTUALE PËR SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRA TË NDOTURA.....	52
ANEKSI 3 - REALIZIMI I TKP PËR VITIN 2014.....	53
ANEKSI 4 - LISTA EKZISTUESE E NJËSIVE BRENDA DHE JASHTË ZONËS SË JURIDIKSIONIT TË SHOQËRIVE UK.....	54

Shkurtime

ERRU	-	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
KKRR	-	Komisioni Kombëtar Rregullator
GIZ	-	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KFW	-	Banka Gjermane për Zhvillim
DPUK	-	Drejtoria e Përgjithshme Ujësjetllës Kanalizime
MTI	-	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MM	-	Ministria e Mjedisit
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
ISHP	-	Instituti i Shëndetit Publik
DRSH	-	Drejtoria Rajonale e Shëndetit
DSHP	-	Drejtoria e Shëndetit Publik
USAID	-	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
SHUKALB	-	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
UK	-	Ujësjetllës Kanalizime
TKP	-	Treguesit Kryesorë të Performancës
O&M	-	Operim dhe Mirëmbajtje

Fjala Hyrëse

Kam kënaqësinë të paraqes para jush Raportin Vjetor 2014, ku përveç aktiviteteve dhe arritjeve të Institucionit tonë në përmbushje të mandatit ligjor, është analizuar dhe paraqitur edhe gjendja aktuale e sektorit ujësjellës-kanalizime në Shqipëri.

Krijimi i një mjedisi rregullator, ligjor dhe transparent është fokusi i punës sonë dhe në këtë kontekst, ERRU gjithmonë ka mbështetur qeverisjen qendrore në reformat e herëpashershme në sektorin e ujësjellës kanalizimeve duke u kthyer kështu në një rregullator të qëndrueshëm për tregun, operatorët, pronarët e tyre dhe mbi të gjitha për konsumatorët e të gjitha kategorive.



Edhe ky vit do të shënojë vendimmarrje të rëndësishme nga ana e politike-bërësve në lidhje me organizimin e ri territorial, organizimin e funksionimit të sektorit UK dhe funksionet e njësive të reja të qeverisjes vendore. ERRU do të mbështesë vendimmarrjen politike në realizimin e këtyre reformave të suksesshme për sektorin ujësjellës kanalizime. Deri më tani jemi munduar që ta përmbushim këtë sfidë, duke qene pjesë aktive në diskutimet për reformimin e sektorit UK.

Gjithashtu, gjatë këtij viti ERRU pritet të marrë dhe një funksion të ri, atë të vendosjes së tarifave për mbetjet.

Enti Rregullator i Ujit drejtohet nga një organ kolegjal në përbërjen e të cilit ushtrojnë funksionin e anëtarëve të Komisionin Kombëtar Rregullator, 5 komisionerë me kohë të plotë. Pavarësisht se në vitin 2014, 65% e përbërjes së KKRR u rinovua, përgjegjshmëria dhe përkushtimi ndaj këtij funksioni ligjor ka bërë që megjithë ndryshimet, komisioni të zhvillojë në mënyrë profesionale rreth 18 mbledhje, ku janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme. Në këtë kuadër, dua të falenderoj dhe anëtarët e rinj të komisionit të cilët me të marrë funksionet, u përshtaten menjëherë me misionin dhe objektivat e Rregullatorit.

Fokusi kryesor për ERRU-në gjatë vitit 2014 ka qenë licencimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator përkatës. Për këtë qëllim ERRU ka rishikuar hapat e ndjekur gjatë procesit të licencimit, ka përcaktuar afate të qarta për çdo hap të procedurës, të shoqëruara këto me marrjen e masave përkatëse sipas ligjit. Gjithashtu po punon ngushtësisht nën asistencën e GIZ për të rritur dhe rolin e tij monitorues në këtë drejtim.

Përmbushja e objektivave të përcaktuara nga shoqëritë UK ka qenë faktor determinues gjatë procesit të rishikimit të tarifave. Rëndësi e veçantë i është kushtuar krijimit të kushteve për qëndrueshmëri financiare të shoqërive UK por në qendër të vëmendjes tonë mbetet gjithmonë mundësia e pagesës së faturave nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Megjithëse ka akoma vend për rritje të mëtejshme të tarifave, duhet mbajtur parasysh raporti ndërmjet përballimit të tarifave nga konsumatorët dhe arritjes së pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorëve. Përballueshmëria ngelet sfiduese jo vetëm për ERRU-në. Gjithsesi, ERRU është e gatshme të bashkëpunojë me të gjithë aktorët në sektor për të gjetur zgjidhjen më të mirë të

mundshme me qëllim mbrojtjen e shtresave të konsumatorëve dhe në veçanti të atyre me të ardhura të ulta dhe në nevojë.

Politika tarifore e ndjekur nga ERRU, ka çuar në efekte të dukshme për 7-8 shoqëri ujësjellës kanalizime, të cilat kanë kaluar prapun e vendosur nga ERRU, për sigurimin e një qëndrueshmërie financiare në përballimin e kostove të shërbimeve që ato ofrojnë. Edhe shoqëritë, sidomos ato të mesme dhe të mëdha, kanë treguar përmirësime në objektiva, por rezultatet janë akoma larg nga objektivat që ERRU ka vendosur në sektor. Shoqëritë duhet të vazhdojnë të jenë të kujdesshëm në analizën për kostot e shërbimeve që kryejnë, sidomos në kostot e personelit dhe energjisë elektrike. Gjithashtu, vihet re se dhe në vitin 2014, niveli i matjes ka pasur ndryshime të vogla pozitive krahasuar me vitin 2013, ndërsa uji pa të ardhura dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë nuk kanë ndryshuar krahasuar me një vit më parë.

Rritja e performancës financiare të shoqërive UK, kryesisht për shkak të politikës tarifore sjell në vëmendje të ERRU-së forcimin e monitorimit për përmirësimin e performancës së tyre. Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion të besueshëm dhe një monitorim të vazhdueshëm. Monitorimi krijon mundësi për të bërë një vlerësim më realist të performancës së çdo shoqërie dhe për të vendosur objektivat sa më realiste, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të tyre. Për ERRU, saktësia dhe besueshmëria e të dhënave është tashmë një nga sfidat për të ardhmen.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij sektori si dhe të drejtën e çdo qytetari për të pasur shërbim të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, ERRU beson dhe shpreson se në ushtrimin e mandatit të tij rregullator do të vazhdojë të ketë mbështetjen e të gjitha institucioneve qendrore përgjegjëse, në përballimin e sfidave për sigurimin e një ecurie të kënaqshme të këtij sektori.

Dëshiroj gjithashtu t'ju siguroj se, sikurse gjatë vitit 2014, edhe në të ardhmen, ERRU me të njëjtin përkushtim do të kontribuojë në rritjen e profesionalizmit, transparencës, bashkëpunimit ndërinstytucional brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë që me autoritetin e tij rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur mes ofruesve të shërbimit, politikë-bërësve dhe konsumatorit.

Shpresoj se informacionet dhe rekomandimet e këtij Raporti do të jenë të dobishme për të gjitha palët e interesit të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e politikave në sektorin e ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri.

Në përfundim, do të doja të falenderoja të gjithë punonjësit e ERRU-së për punën dhe dedikimin që kanë treguar në realizimin e objektivave të tyre, si dhe këshilltarët e GIZ për bashkëpunimin e frytshëm gjatë gjithë këtyre viteve pune të përbashkët.

Avni **DERVISHI**



KRYETAR

Enti Rregullator i Ujit

1. Veprimtaria vjetore e ERRU-së

Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU) është një institucion i pavarur publik që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Bazuar në nenin 31 të këtij ligji, "Mbledhja e raporteve dhe e informacionit", pika 1, ERRU çdo vit duhet t'i paraqesë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, një raport vjetor ku të përshkruhet puna njëvjeçare e Entit, parashikimet për zhvillimet e vitit pasardhës si dhe gjendja e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri.

Në korrik të vitit 2014, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi për herë të parë një **rezolutë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2013"**, duke vlerësuar rolin e tij në sektorin ujësjellës kanalizime.

Direktivat e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

- *Të angazhohet në forcimin e pavarësisë institucionale dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tij në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese;*
- *Të angazhohet në forcimin e kapaciteteve të tij administrative;*
- *Të jetë i vëmendshëm në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, për sa i përket cilësisë së shërbimeve të ofruara nga operatorët në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura;*
- *Të ketë parasysh gjetjen e balancës mes mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit, gjatë procesit të vendosjes së tarifave;*
- *Të vazhdojë të monitorojë performancën dhe ecurinë e shërbimit të operatorëve ujësjellës-kanalizime, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të tyre ndaj konsumatorit dhe t'i orientojë ata drejt efikasitetit të energjisë, e cila ka ndikim të madh në strukturën e kostos.*

Në punën e tij gjatë vitit 2014, ERRU përveç realizimit të mandatit të tij rregullator të përcaktuara në ligj, u mbështet edhe në direktivat e përcaktuara në këtë rezolutë.

1.1. Statusi ligjor dhe përgjegjësitë

Qëllimi kryesor i ligjit 8102 mbi të cilin funksionon ERRU, është vendosja e një kuadri rregullator dhe ngritja e një Enti të pavarur për të garantuar e mbrojtur interesat publike dhe për të krijuar një mjedis transparent ligjor dhe rregullator në sektor.

Vizioni i ERRU është: “Një sektor ujësjellës-kanalizime financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri”.

Misioni i ERRU është: “Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë me të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht”.

Detyrat e përgjithshme të ERRU janë:

- Të nxisë eficiencyn dhe përdorimin me efikasitet të ujit;
- Të bëjë të mundur që të licencuarit të financojnë veprimtaritë e autorizuara nga licenca që kanë marrë;
- Të mbrojnë interesat e konsumatorëve në lidhje me:
 - çmimet, tarifat dhe kushtet e shërbimit;
 - cilësinë, eficiencyn dhe vijueshmërinë e këtij shërbimi jetik për të gjithë konsumatorët;
 - garantimin e të drejtave për të ankimuar dhe standardeve të shërbimit;
- Të nxisë konkurrencën;
- Të gjejë një ekuilibër të drejtë ndërmjet pjesëmarrësve të këtij sektori, duke respektuar interesat e konsumatorëve, qeverisë, publikut dhe investitorëve.

ERRU ka gjithmonë në fokus konsumatorin, në rregullimin ligjor e të drejtë të këtij shërbimi jetik që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe shëndetit për të gjithë, duke përdorur një sërë instrumentash rregullatore:

- Vlerësimin e përballueshmërisë së tarifave
- Seancat dëgjimore me publikun të detyrueshme për fillimin e procesit të ndryshimit të tarifave
- Tregues të performancës për të matur korrektësinë e operatorëve në trajtimin e ankesave të konsumatorëve
- Kontrata model për shërbimet ujësjellës - kanalizime

Me konkretisht në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, ERRU përdor disa instrumenta rregullatore:

- Me anë të metodologjisë për vendosjen e tarifave, ka sanksionuar **përballueshmërinë** si një nga objektivat e politikës tarifore. Gjatë vitit 2014 për secilin nga aplikimet për ndryshim tarife, ERRU u kujdes që shtresat me të ardhura të ulta të popullsisë të mos paguajnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
- Operatorët e mëdhenj¹ që aplikuan për ndryshimin e tarifave, organizuan **seancën dëgjimore** me publikun, një mjet i detyrueshëm tashmë prej 3 vitesh për fillimin e procesit të ndryshimit të tarifave. Për ta forcuar akoma më shumë këtë moment të rëndësishëm, gjatë vitit 2014 ka filluar hartimi i një udhëzuesi mbi parimet dhe procedurën e organizimit të këtyre seancave me publikun, i cili pritet të përfundojë në vitin 2015.
- Një tjetër aspekt që u pa i arsyeshëm të përmirësohej në vitin 2014 ishte **roli i marrëdhënies së operatorit me konsumatorin** në vlerësimin e performancës së shoqërive. Pjesë e projektit të ERRU për "Sistemin e raportimit rregullator" (i cili do të trajtohet më gjerësisht në temën "Përmirësimi i instrumentave rregullatore") është edhe shtimi i treguesit të performancës që do të masë korrektësinë e operatorëve në trajtimin e ankesave të konsumatorëve.
- ERRU ka përdorur vendosjen e standardeve për sektorin si një mjet për të mbrojtur interesat e konsumatorëve. Në shtator të vitit 2014 **kontrata model për shërbimet ujësjellës - kanalizime** është bërë e aplikueshme dhe ka hyrë në fuqi për të gjithë klientët e sektorit UK edhe pse mund të mos e kenë nënshkruar atë.

Mbrojtja e konsumatorit lidhet dhe me çështjen e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave. Ky proces mbetet një nga problemet më të ndjeshme në marrëdhënien mes ERRU-së dhe konsumatorëve, i cili ka jo pak vështirësi në trajtim.

Parashikimi ligjor që çdo person mund ti dërgojë Komisionit një ankesë me shkrim dhe ky i fundit do të njoftojë operatorin duke i lënë mundësi të përgjigjet me shkrim, nuk çon në një zgjidhje përfundimtare. ERRU është në rolin e një ndërmjetësi, i cili, gjithsesi nuk ka mundësi të marrë një vendim mbi të drejtën ose jo të konsumatorit. Këtë situatë nuk e favorizojnë aspak as parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, disa prej të cilave janë të vjetra në kohë e nuk i përgjigjen zhvillimeve aktuale. Këto rregullime ligjore nuk janë të harmonizuara me legjisllacionin në fuqi duke rregulluar pjesërisht të drejtat e detyrimet e palëve.

¹ - Operatorët që ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë për një popullsi prej 100 000 banorësh në zonën e tij të shërbimit;

- Operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për një popullsi prej 50 000 banorësh në zonën e tij të shërbimit.

Në këtë situatë pjesë e zgjidhjes së këtij problemi, do të ishin ndryshimet që priten ti bëhen ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ku pjesë e të cilave është dhe shtimi i kompetencës së KKRR për marrjen e vendimit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

Qëllimi kryesor i ndryshimit të ligjit nr. 8102, është shtimi i një funksioni të ERRU-së, atë të rregullimit tarifor për shërbimin e depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta në landfille dhe impiante incenerimi.

Nevoja e këtij ndryshimi buron nga mungesa e një autoriteti qendror rregullator të veçantë që shqyrton dhe miraton tarifatat apo ndryshimet në tarifatat e depozitimit të mbetjeve.

Delegimi i kësaj kompetence pranë ERRU është parashikuar edhe në "Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve".

Gjithashtu, në këtë paketë ndryshimesh ligjore, përveç shtimit të kompetencës së KKRR për marrjen e vendimit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve janë propozuar edhe disa ndryshime të tjera me qëllim forcimin dhe rritjen e rolit të ERRU-së, siç janë:

- emërimin të anëtarëve të Komisionit Kombëtar Rregullator nga Kuvendi;
- rritjen e pavarësisë financiare;
- rritjen e masës së sanksioneve ndaj operatorëve të shërbimeve;

Këto ndryshime përputhen me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017.


1.2. Forma organizative e ERRU-së

*ERRU drejtohet nga **Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR)**, i cili ushtron këto kompetenca të përgjithshme:*

- *Jep licenca për njësitë komerciale që janë të angazhuara në kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura;*
- *Miraton çmimet dhe tarifatat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifatat për ujërat e ndotura dhe tarifatat e trajtimit të tyre;*
- *Krijon dhe garanton zbatimin e standardeve të punës për të licencuarit;*
- *Inkurajon standarde dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin;*
- *Përgatit raporte për gjendjen e sektorit për Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin si dhe grumbullon informacionin përkatës nga të licencuarit;*


Struktura dhe organika e ERRU është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendim nr. 94, datë 30.04.2007, i ndryshuar.

Një skemë e kësaj strukture të ERRU është paraqitur më poshtë:



Në përbërje të ERRU janë 5 Komisionerë, 13 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës. Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve është si më poshtë:

Grafiku 1: Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve



1.3. Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese

- **Licencimi i operatorëve ujësjellës-kanalizime**

Në sektorin ujësjellës - kanalizime operojnë gjithsej 57 shoqëri të cilat ofrojnë një apo disa nga shërbimet e mëposhtme:

- grumbullimin, shpërndarjen e ujit për konsum publik (57 shoqëri);
- përpunimin e ujit për konsum publik (2 shoqëri);
- largimin e ujërave të ndotura (28 shoqëri);
- përpunimin e ujërave të ndotura (4 shoqëri).

Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 23.03.1996, i ndryshuar dhe Rregulloren e Licencimit, miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009, e ndryshuar, çdo person fizik ose juridik që ushtron aktivitetin e tij në sektorin ujësjellës kanalizime duhet të jetë i licencuar.

Me marrjen e licencës, personit fizik ose juridik i jepet e drejta e ofrimit të shërbimeve të sipërpërmendura.

Gjatë vitit 2014 kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licence, 22 shoqëri ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të gjithë dokumentacionit të kërkuar, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar 13 (trembëdhjetë) operatorë, ndërsa 9 (nëntë) aplikime të tjera mbeten ende në proces.

Po gjatë këtij viti, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar dhe 2 (dy) shoqëri të tjera, aplikimet e të cilave vinin nga viti paraardhës, por që dokumentacioni u plotësua nga shoqëritë në vitin 2014.

Aplikimet e mësipërme kanë ardhur nga 14 (katërmëdhjetë) shoqëri si pasojë e përfundimit të afatit të licencës, nga 5 (pesë) shoqëri si pasojë e ndryshimit të drejtuesit ligjor/teknik, nga 1 (një) shoqëri si pasojë e shtimit të kategorisë së grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura dhe nga 1 (një) shoqëri si pasojë e ndryshimit të formës ligjore dhe pronësisë. Kjo shoqëri është ujësjellës-kanalizime Elber sh.p.k., deri më tani me pronar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, e cila u transformua në një shoqëri aksionare, ujësjellës - kanalizime Elbasan sh.a. me pronar Bashkinë Elbasan.

Gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licencë apo rinovim licence gjatë vitit 2014, nga ana e shoqërive që operojnë në sektorin UK, u hasën përsëri problematika që janë të njohura për ERRU-në. Ndër to, si më kritike, mund të përmendim:

- **Ndryshimi i drejtuesit ligjor/teknik** brenda një periudhe shumë të shkurtër (dhe disa herë brenda një viti), rreth 12 raste, ku mund të përmendim sh.a UK Durrës, sh.a UK Librazhd, sh.a UK Fushë Krujë, sh.a U Ura Vajguore, sh.a U Novoselë, etj

- Vështirësi në gjetjen e **një drejtuesi të kualifikuar teknik** rreth 7 raste, ku mund të përmendim sh.a UK Kukës, sh.a U Korçë-Fshat, sh.a U Has, sh.a U Rrëshen, sh.a U Patos etj. ose një drejtuesi të dytë për shoqëritë që kanë në funksionim impiante;
- Vështirësi për **shlyerjen e pagesës së licencimit** tek ERRU nga pothuajse të gjitha shoqëritë;
- Vështirësi në **regjistrim dhe reflektimin e ndryshimeve në QKR**, rreth 6 raste, ku mund të përmendim sh.a U Rrëshen, sh.a UK Mallakastër, sh.a UK Këlcyrë sh.a UK Kukës, sh.a UK Fushë Arrëz, sh.a U Has;
- Vonesa në **dorëzimin e dokumenteve të nevojshme** nga ana e shoqërive për nisjen e procedurës së licencimit, pothuajse nga të gjitha shoqëritë. Kryesisht vonesa ka pasur në marrjen e akti miratimit higjieno - sanitar, lejet e mjedisit (në rastin e kategorisë së përpunimit të ujërave të ndotura), autorizimit nga pronari, dëshmitë e penaltetit, por nuk mungojnë rastet kur dokumentacioni vonohet si pasojë e neglizhencës nga ana e shoqërisë.


ERRU si institucion ka qenë gjithmonë bashkëpunues dhe i gatshëm për të ndihmuar dhe mbështetur shoqëritë në zgjidhjen e këtyre problemeve. Stafi i ERRU-së ka zhvilluar takime të ndryshme jo vetëm me vetë shoqëritë, por edhe me institucionet e tjera, për të garantuar mbështetjen e nevojshme në zgjidhjen e tyre.

Gjithsesi mbetet për t'u theksuar që janë shoqëritë UK dhe njësitë e qeverisjes vendore si pronarë të tyre, ato që duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të kapërcyer këto probleme.

Për shkak të problematikave të paraqitura më sipër, situata e licencimit deri në fund të vitit 2014, për 57 shoqëritë UK që operojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime është si më poshtë:

- **40 (dyzet)** operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- **9 (nëntë)** operatorë janë në proces të rinovimit të licencës
- **5 (pesë)** operatorë u ka përfunduar afati dhe nuk kanë aplikuar akoma për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencim;
- **3 (tre)** operatorë janë pa licencë.

Grafiku 2. Situata aktuale e licencimit



Tek operatorët pa licencë përfshihet dhe ujësjellës Peqin sh.a, së cilit i është pezulluar licenca, për arsye të problemeve me cilësinë e ujit (fortësi të ujit mbi normën e lejuar), deri në plotësimin e standardeve të lejuara. Për këtë problematikë është njoftuar pronari, pushteti vendor, me qëllim që të njoftohen konsumatorët që uji i furnizuar nuk i plotëson standardet e lejuara. Janë informuar gjithashtu Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Edhe këtë vit, vazhdon të ketë raste kur **njësitë e qeverisjes vendore e kryejnë vetë shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura** dhe nuk e kanë transferuar këtë funksion pranë shoqërive të ujësjellësit në varësi të njësisë përkatëse.

Ka raste kur disa njësi vendore e kanë transferuar shërbimin e kanalizimit tek shoqëria UK, por këto të fundit vazhdojnë të mos e kryejnë aktivitetin dhe nuk kanë mundur të plotësojnë dokumentet përkatëse në përputhje me aktet nënligjore, për t'u licencuar dhe për këtë shërbim. Një nga problemet e shoqërive në këto raste ka qenë dhe **rivlerësimi, inventarizimi dhe dorëzimi i aseteve nga pushteti vendor tek shoqëria**. Këtu mund të përmendim rastin e ujësjellës Orikum sh.a dhe ujësjellës Bilisht sh.a.

• **Tarifat dhe procesi tarifor**

ERRU është autoriteti që miraton tarifën e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifën për grumbullimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin e tyre, për të gjithë të licencuarit në sektorin ujësjellës-kanalizime.

Detyra kryesore për ERRU në miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura është:

- të mbrojë konsumatorët nga çmimet monopol,
- t'u bëjë të mundur të licencuarve të rikuperojnë kostot e arsyeshme të kryerjes së një shërbimi efektiv, duke përfshirë dhe mundësinë për të siguruar një fitim mbi investimin, që është i mjaftueshëm për përmirësime dhe ndërtime të reja.

Prandaj, objektivi kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit.

Bazuar në kompetencat që i jep ligji, ERRU ka përcaktuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në “Metodologjinë për vendosjen e tarifave”, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë subjektet e licencuar.

Në këtë metodologji, procesi tarifor trajtohet duke pasur parasysh parimet e mëposhtme:

Mbulimi i kostos	Tarifat rriten gradualisht derisa arkëtimet të mbulojnë të gjitha kostot, përfshi amortizimin dhe interesat e huave
Efikasiteti menaxhues	Ofruesit e shërbimit duhet të demonstrojnë progres të matshëm në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare para se ERRU të miratojë rritje tarifash
Përballueshmëria	Familjet me të ardhura të ulta duhet të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat bazë të konsumit duke shpenzuar jo më shumë se 5% e të ardhurave të tyre për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime
Efikasiteti mjedisor	Struktura e tarifave duhet të nxisë ruajtjen e burimeve dhe nivele të qëndrueshme konsumi

ERRU duhet ti sigurojë konsumatorët se tarifat që ata paguajnë bazohen në kostot e domosdoshme dhe të arsyeshme për shërbimet e ofruara. Pjesa më e madhe e operatorëve akoma nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot totale për shërbimet që ata kryejnë. Mbulimi i tyre do të kërkonte rritje të ndjeshme të tarifave, të cilat mund të mos përballohen nga konsumatorët. Synimi i ERRU-së **është mbulimi i menjëhershëm i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, ndërsa mbulimi i kostove totale është objektiv më i largët.**

Rritja e tarifave sjell më shumë të ardhura për operatorët, por nëse ofrimi i shërbimit nuk përmirësohet, konsumatorët paguajnë më shumë për një shërbim jo cilësor. Për këtë arsye, politika tarifore e ndjekur nga ERRU përfshin **një rritje graduale të tarifave në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet me përmirësime të performancës së shërbimeve.**

Në vitin 2014, pranë ERRU paraqitën kërkesën për ndryshimin e tarifave 12 shoqëri, (Aneksi 1) prej të cilave:

- Sh.a UK Fier, Sh.a UK Gjirokastër, Sh.a UK Lezhë, Sh.a UK Lushnjë, Sh.a UK Sarandë, Sh.a UK Ersekë dhe Sh.a UK Korçë janë shoqëri të cilat kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave edhe në vitin paraardhës. Për këto shoqëri aplikimi i përvitshëm për ndryshimin e tarifave bazohet në planet e tyre të biznesit.
- Sh.a UK Himarë dhe Sh.a U Korçë Fshat aplikojnë për herë të parë për miratimin e tarifave pranë ERRU-së.
- Shoqëritë sh.a UK Krujë, sh.a U Elbasan Fshat dhe sh.a U Poliçan, aplikojnë tarifa të miratuara nga ERRU përkatësisht në vitin 2007, 2010 dhe 2011.

Gjithashtu, edhe sh.a U Mallakastër ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e tarifave, por nuk ka plotësuar dokumentacionin e aplikimit. Për këtë arsye, komisioni nuk e mori në shqyrtim këtë aplikim.

Bazuar në Metodologjinë "Për miratimin e tarifave", të miratuar nga KKRR, shoqëritë duhet fillimisht të plotësojnë dokumentacionin e aplikimit. Nëse dokumentacioni i aplikimit nuk është i plotë, procedura e miratimit të tarifave (e cila kalon në disa hapa), fillon pas plotësimit të këtij dokumentacioni. Paraqitja e aplikimeve nga operatorët bëhet brenda datës 30 qershor të çdo viti. Afati i fundit për miratimin e tarifave nga Komisioni Kombëtar Rregullator është 30 marsi i vitit pasardhës.

Në lidhje me aplikimet e paraqitura për ndryshimin e tarifave në vitin 2014, rezultoi se me përjashtim të sh.a UK Korçë, shoqëritë e tjera nuk e kishin plotësuar dokumentacionin në përputhje me kërkesat e Metodologjisë. Këtyre shoqërive iu kërkua zyrtarisht plotësimi i dokumentacionit të munguar, si kusht për vazhdimin e procesit. ERRU do të shqyrtojë kërkesat e paraqitura për ndryshimin e tarifave rast pas rasti në varësi të plotësimit të dokumentacionit të aplikimeve për ndryshimin e tarifave në përputhje me kërkesat ligjore dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Për sh.a UK Korçë procesi i miratimit të tarifave është në hapat e fundit. KKRR ka përfunduar shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimit të kësaj shoqërie për ndryshimin e tarifave, dhe ka bërë transparent mendimin e tij tek operatori dhe Këshilli i Bashkisë Korçë. Brenda muajit janar 2015, KKRR do të marrë vendim në lidhje me ndryshimin e tarifave.

ERRU ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e të gjithë operatorëve për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, për të siguruar cilësinë, eficientë dhe vijueshmërinë e shërbimeve që ato ofrojnë për të gjithë konsumatorët. Tarifa luan një rol të rëndësishëm në këtë proces, por ERRU në asnjë rast nuk e vazhdon procedurën për miratimin e tarifave, nëse aplikimi nuk është plotësuar sipas kërkesave të Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave".


Gjithashtu, në muajin mars të vitit 2014, KKRR miratoi tarifën për sh.a UK sh.a. UK Fier, sh.a UK Lushnjë Qytet dhe sh.a UK Berat-Kuçovë. Për këto shoqëri procesi i miratimit të tarifave kishte filluar sipas aplikimeve të paraqitura për ndryshimin e tarifave në vitin 2013. Këta operatorë bëjnë pjesë në Programin Komunal të infrastrukturës të kredituar nga Banka Gjermane për Zhvillim. Për të qenë pjesë e investimeve të KFW, këta operatorë duhet të arrijnë të mbulojnë me të ardhurat e arkëtuara koston e operimit dhe mirëmbajtjes plus koston e kredisë (interesa dhe principalin). Përqindja e mbulimit të këtyre kostove është përcaktuar në marrëveshjet respektive. Shlyerja e këtyre kredive si dhe mbulimi i kostove në rritje kërkon sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme.

Komisioni Kombëtar Rregullator në vendimmarrjen e tij është përpjekur që nëpërmjet rishikimit periodik të tarifave për këta operatorë të kredituar me hua, të përmirësojë hap pas hapi mbulimin e kostove me qëllim uljen e subvencioneve dhe krijimin e mundësive për shlyerjen e këtyre kredive, por pa lënë mënjanë edhe **vlerësimin dhe monitorimin e objektivave të arritura nga këto shoqëri**, si një nga parimet bazë të procesit tarifor.

Monitorimi jep mundësi të bëhet vlerësimi real i punës së çdo operatori dhe të vendosen objektiva sfiduese por të arritshme, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të shoqërive.

Duke pasur parasysh këtë objektiv, ERRU gjatë vitit 2014 monitoroi zbatimin dhe efektin e ndryshimit të tarifave të miratuara në vitin 2013 nga KKRR për sh.a UK Sarandë, sh.a UK Korçë, sh.a UK Berat-Kuçovë, sh.a UK Lezhë, sh.a UK Fier, sh.a UK Gjirokastrë, sh.a UK Lushnjë Qytet, sh.a UK Ersekë, sh.a UK Bashkia Pukë dhe sh.a UK Peshkopi (tarifat aktuale të zbatuara gjatë vitit 2014 nga operatorët e këtij shërbimi jepen në Aneksin 2 të këtij raporti).

Grafiku 3: Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes




Nga ky monitorim rezulton se ERRU nëpërmjet strukturës së miratuar të tarifave për secilën nga këto shoqëri, ka arritur objektivin e politikës tarifore. Mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes, për të bërë të mundur që gradualisht të arrihet dhe mbulimi i kostos totale.

Për vitin 2014, mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes me të ardhurat² nga shërbimet UK është rritur krahasuar me vitin 2013.

Ky rezultat është arritur jo vetëm nga rritja e të ardhurave por edhe ulja e shpenzimeve. Gjatë vitit 2014, me përjashtim të sh.a UK Bashkia Pukë dhe sh.a UK Peshkopi, operatorët e tjerë i kanë ulur kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, krahasuar me një vit më parë.

²Bazuar në rezultatet e pritshme për vitin 2015, të projektuara bazuar në dhënat 9-mujore të sjella nga shoqëritë

Grafiku 4. Ndryshimi i kostos O&M dhe të ardhurave. në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013




Rritja e të ardhurave ka ardhur si rezultat i ndryshimit të tarifave dhe përmirësimit të menaxhimit. Edhe për vitin 2014, rritja më e madhe e të ardhurave vjen si rezultat i rritjes së tarifave.

Për të vendosur një raport sa më të mirë ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave, shoqëritë duhet të punojnë si për të rritur të ardhurat ashtu dhe për të ulur kostot e shërbimeve, duke rritur efijencën operacionale në lidhje me faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave si dhe kontrollin e kostove.

Ndonëse të gjitha shoqëritë e analizuar mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, vetëm dy prej tyre, sh.a UK Gjirokastër Qytet dhe sh.a UK Ersekë, mbulojnë edhe kostot totale.

Grafiku 5: Mbulimi i kostos totale



Shoqëritë sh.a UK Korçë, sh.a UK Sarandë, sh.a UK Berat - Kuçovë, sh.a UK Lezhë, sh.a UK Fier, sh.a UK Lushnjë në vite kanë kryer investime, financimi i të cilave është bërë nëpërmjet kredive, kështu që aktualisht ato janë të detyruara të paguajnë interesat e kredisë si edhe kanë filluar dhe shlyerjet e kësteve të plota (principalet e kredive). Për këto shoqëri, ERRU nëpërmjet ndryshimit të tarifave po synon rritjen e të ardhurave jo vetëm për të mbuluar kostot e shërbimit, por aktualisht për të mbuluar dhe kostot e kredive.

Rritja e të ardhurave duhet të shoqërohet dhe me përmirësimin e shërbimit, i cili aktualisht nuk është në nivele të mira. Për shoqëritë është e nevojshme të analizohen në veçanti treguesit si uji pa të ardhura, niveli i matjes, eficienta e stafit, eficienta e energjisë, në përputhje me objektivat e vendosura nga ERRU (objektivat për TKP dhe realizimi i tyre për vitin 2014, paraqiten në Aneksin 3)

Ulja e nivelit të humbjeve, rritja e nivelit të matjes, reduktimi i stafit të tepërt dhe rritja e eficientës në punë, janë objektiva emergjente të shoqërive që çojnë në ulje të shpenzimeve jo efektive dhe rritje të të ardhurave.

• **Përballueshmëria e tarifave**

Sektori ujësjellës-kanalizime është në proces përmirësimi dhe zgjerimi të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në të gjithë vendin. Infrastruktura ekzistuese e këtyre shërbimeve ka nevojë për rehabilitim, zëvendësim ose shtrirje të mëtejshme.

Duke pasur parasysh angazhimet që Shqipëria ka për të arritur pajtueshmërinë me direktivat kryesore të BE lidhur me mjedisin, trajtimi i ujërave të ndotura mbetet një fushë prioritare.

*Një nga objektivat kryesore të politikës tarifore është përballueshmëria e pagesës së tarifave të shërbimeve UK nga konsumatorët familjarë. Megjithëse ka akoma vend për rritje të mëtejshme të tarifave, duhet mbajtur parasysh **raporti ndërmjet përballimit të tarifave nga konsumatorët dhe arritjes së pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorëve**. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme po të marrim në konsideratë konsumatorët me të ardhura të ulëta dhe ata në nevojë.*

Financimi i këtyre investimeve bëhet kryesisht nëpërmjet huave ose nga fondet e buxhetit të shtetit. Trajtimi i ujërave të ndotura është një shërbim i kushtueshëm. Kostot e këtij shërbimi si dhe kostot e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duhet të mbulohen me të ardhurat nga faturimi i shërbimeve tek konsumatorët. Kjo do të thotë se tarifat duhet të rriten për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të operatorëve dhe vazhdimësinë e shërbimeve.

Për ERRU, përballueshmëria e tarifave nga konsumatorët ka qenë dhe është një shqetësim, prandaj është përpjekur, duke përdorur instrumentet e tij, të bëjë të mundur që tarifat e miratuara të jenë dhe të përballueshme për konsumatorët. Këto instrumente kryesisht janë:

- Në përputhje me Metodologjinë "Për Vendosjen e Tarifave", një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan **struktura tarifore**: tarifë fikse dhe tarifë variabël me blloqe konsumi, e cila krijon mundësinë për të paguar më pak për konsum më të ulët. Në kushtet kur skemat e subvencionimit për familjet me të ardhura të ulta nuk janë të përcaktuara, struktura tarifore përcakton një tarifë të përballueshme për nevojat bazë të konsumit për këtë kategori konsumatorësh. Aplikimi i kësaj strukture tarifore kërkon që konsumatorët të jenë pajisur me matës. Blloku i parë, i sugjeruar 4.5 m³ për familje në muaj, tarifohet në mënyrë preferenciale për të lehtësuar aksesin në nevojat bazë për ujë duke ju përafuar përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara (UN) mbi "Të drejtat e njeriut për ujë të pijshëm dhe kanalizime" të cilën Shqipëria e ka njohur zyrtarisht që më 24 mars 2011.
- **Subvencioni i kryqëzuar** është një formë e subvencionimit, i cili ndihmon këtë proces. Për konsumatorët jofamiljarë dhe konsumatorët familjarë me nivel të lartë konsumi, niveli i tarifave është më i lartë, duke bërë kështu të mundur që operatorët të sigurojnë të ardhurat për mbulimin e kostove.
- Një formë tjetër është edhe **organizimi i seancës dëgjimore** me publikun si një nga instrumentet që përdor ERRU, e cila sjell informacion mbi pritshmërinë dhe gatishmërinë e konsumatorëve për të paguar, kryesisht nga ata familjarë.
- Një ndër rolet kryesore të ERRU është **monitorimi i efikasitetit dhe efektivitetit** të ofruesve të shërbimit. Qëllimi i këtij monitorimi është minimizimi i kostove në mënyrë që shërbimet të jenë më të përballueshme.

Nga ana tjetër edhe buxheti i shtetit ka vazhduar të subvencionojë drejtpërdrejt shoqëritë duke mbuluar kosto operative të caktuara. Në këtë mënyrë mbulimi i kostove operacionale arrihet nga tarifat dhe subvencionet.

Duke marrë për bazë të ardhurat mesatare mujore³ për familje dhe vlerën e faturës për shërbimet UK, për një familje me konsum mesatar (18 m³ në muaj), për operatorët që u është miratuar tarifa gjatë vitit 2014, është përlogaritur pjesa që zë, në të ardhurat familjare, pagesa për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (e cila nuk duhet të kalojë 5% të të ardhurave).

Kjo analizë të ndihmon për të gjykuar, nga pikëpamja e përgjithshme, situatën e përballueshmërisë. Megjithatë situata individuale brenda zonave të shërbimit të një shoqërie është e ndryshme dhe arritja e konkluzioneve më të drejta në lidhje me përballueshmërinë

³ të dhënat janë marrë nga INSTAT dhe përfaqësojnë të ardhurat mesatare për familje në rrethin përkatës

kërkon analiza më të detajuara në lidhje me të ardhurat për familje për çdo zonë, numrit të familjeve me të ardhura të ulëta në secilën prej tyre, etj.

Tabela 1: Përqindja e vlerës së faturës kundrejt të ardhurave për familje

Operatori	Vlera e faturës (lek/muaj)	Të ardhurat mesatare për familje (lek/muaj)	Vlera e faturës / Të ardhurave (%)
Sha UK Ersekë	891	42,464	2.1%
Sha UK Gjirokastër	942	48,327	2.0%
Sha UK Korçë	1,940	42,464	4.6%
Sha UK Lezhë	1,599	47,081	3.4%
Sha UK Pukë	891	40,865	2.2%
Sha UK Sarandë	949	48,327	2.0%

Siç shihet edhe nga tabela, raporti i vlerës së faturës kundrejt të ardhurave është më e lartë për operatorin UK Korçë dhe UK Lezhë.

UK Korçë sh.a , krahas shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, kryen edhe trajtimin e ujërave të ndotura. Për këtë arsye, kostot e shërbimit janë rritur, gjë e cila është reflektuar edhe në tarifën e këtij shërbimi. Kjo shoqëri megjithëse operon me tarifa të larta, ofron një shërbim mjaft të mirë, konsumatorët janë të kënaqur dhe paguajnë rregullisht për shërbimin e ofruar, por rritja e mëtejshme e tarifave mund të japë efekte negative. Sinjalet e para janë paraqitur. Gjatë dy viteve të fundit vihet re një ulje e nivelit të arkëtimit dhe ulje e nivelit të konsumit nga konsumatorët.

Në vitet e ardhshme, edhe për Sha UK Lezhë e Sarandë, me vënien në funksionim të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, përqindja që do të zërë vlera e faturës në të ardhurat e familjeve do të rritet, pasi konsumatorët do të duhet të paguajnë edhe për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura.

Nga ana tjetër, mbajtja e tarifave në nivel artificialisht të ulët për të gjithë konsumatorët krijon një rreth vicioz të nënfinancimit nga ofruesit e shërbimit, investime të pamjaftueshme dhe përkeqësim të infrastrukturës, e cila për rrjedhojë të çon në uljen e mëtejshme të nivelit dhe cilësisë së shërbimeve për konsumatorët.

Përballueshmëria është e lidhur me shumë çështje si të ardhurat e familjeve, përcaktimin e nivelit minimal të konsumit të ujit për nevojat bazë, çfarë konsiderohet e arsyeshme për tu shpenzuar nga një familje për shërbimet UK, eficienta dhe efektiviteti i ofruesve të shërbimit, riorganizimi i shërbimeve drejt ekonomisë së shkallës, mekanizmat e subvencionimit, etj.

ERRU është e gatshme të bashkëpunojë me aktorë të tjerë për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme për këto probleme, me qëllim mbrojtjen e shtresave të konsumatorëve dhe në veçanti të atyre me të ardhura të ulëta dhe në nevojë.

Në vitin 2014, në kuadër të Programit “Mbështetje për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri”, “Përbalueshmëria e Tarifave për Shërbimet Ujësjellës-Kanalizime për Konsumatorët Familjarë me të Ardhura nën Nivelin e Varfërisë” është trajtuar si një çështje më vete. ERRU ka mbështetur studimin e kryer në këtë drejtim.

Konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të përgatitur nga ekspertët për këtë çështje janë mbajtur parasysh gjatë vlerësimit të ndryshimit të tarifave dhe do të ndihmojnë gjithashtu në zgjidhjen e problemeve që lidhen me përbalueshmërinë.

- **Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit**

Nisur nga objektivi për të pasur një sektor financiarisht të qëndrueshëm i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët, për ERRU, monitorimi dhe vlerësimi i performancës së operatorëve të shërbimit UK dhe sektorit në tërësi merr një rëndësi të veçantë.

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime dhe sektorit UK, deri më tani është bazuar në 10 tregues kryesorë të performancës të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator. ERRU duke pasur parasysh zhvillimet në sektor në tre vitet e fundit (kohë kjo që kur ERRU ka nisur vlerësimin e performancës së shoqërive), është duke rishikuar treguesit e performancës, nivelet e objektivave për performancë të mirë si dhe komponentë të tjerë që ajo përdor për këtë vlerësim krahasues gjatë aplikimeve për tarifë apo gjatë monitorimit të performancës së shoqërive ujësjellës-kanalizime.

Rezultatet e monitorimit të shoqërive UK janë publikuar, nga ERRU, në Raportin e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime që nga viti 2011.

Këto raporte janë të rëndësishme, jo vetëm për shoqëritë që të shikojnë ecurinë e tyre në vite dhe të krahasojnë arritjet e tyre me ato të shoqërive që operojnë në të njëjtin mjedis, por edhe për palët e interesuara si pronarët, Këshillat Mbikëqyrës, konsumatorët, si edhe për vetë rregullatorin.

Analiza e gjendjes dhe ecurisë së sektorit në tërësi dhe zhvillimet apo problemet e evidentuara për çdo shoqëri në veçanti, ndihmojnë në realizimin e misionit të ERRU, por gjithashtu dhe në përmirësimin e standardeve, metodologjive apo praktikave të përdorura në vlerësimin e performancës. Gjithashtu, rezultatet e monitorimit të performancës përdoren nga ERRU edhe në procesin e ndryshimit të tarifave.

ERRU, në zbatim të ligjit 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, kontrollon subjektet e licencuara për zbatimin e këtij ligji, respektimin e kushteve të licencës dhe përdorimin e tarifave të ujit për konsum publik.

Rezultatet e këtyre kontrolleve janë një burim tjetër informacioni në lidhje me monitorimin e performancës së operatorëve.

Në lidhje me sa më lart, në vitin 2014, ERRU ka realizuar një sërë inspektimesh me tematika të ndryshme pranë operatorëve UK. Drejtimet kryesore të këtyre inspektimeve ishin:

- licencimi i operatorëve dhe zbatimi i kushteve të licencës,
- mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm;
- bilanci i ujit dhe menaxhimi i humbjeve
- vazhdimësia e shërbimit, problematikat në rast defektsh të zgjatura
- situata dhe masat që duhen marrë në vijim të fillimit të sezonit turistik
- mbulueshmëria me shërbimin e kanalizimeve në zonë
- trajtimi i ujërave të ndotura,
- investimet në sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura,
- zbatimi i tarifave të miratuara nga ERRU dhe tarifave për shërbimet e tjera,
- zbatimi i kontratës model dhe marrëdhëniet me konsumatorin,
- pagesat rregullatore, etj.

Përveç këtyre inspektimeve të kryera në zbatim të mandatit të tij ligjor, ERRU ka marrë pjesë dhe në Programin për monitorimin e furnizimit me ujë në zonën bregdetare Vlorë-Sarandë iniciuar nga Këshilli i Ministrave në qershor 2014. Monitorimi i situatës, sipas një programi të përcaktuar, krijoi mundësi për të pasur një informacion më të zgjeruar në lidhje me kryerjen e shërbimeve nga shoqëritë UK e sidomos në lidhje me ato komuna pjesë e kësaj zone bregdetare që nuk janë pjesë e juridiksionit të shoqërive UK, por operojnë më vete. Në vijim, ERRU mori pjesë edhe në grupet ndërministrorë të ngritura në kuadër të këtij programi, për vlerësimin e situatës dhe rekomandimeve për përmirësimin e saj.

Vitin në vazhdim, ERRU do të intensifikojë punën në inspektimin shoqërive UK në lidhje me zbatimin e kushteve të licencës, aplikimin e tarifave të miratuara dhe monitorimin e treguesve kryesorë të performancës.

*Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion të besueshëm dhe një monitorim të vazhdueshëm. Monitorimi krijon mundësi për të bërë një vlerësim më të saktë të performancës së çdo shoqërie dhe për të vendosur objektiva sa më realiste, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të tyre. Për ERRU, **saktësia dhe besueshmëria e të dhënave është tashmë një nga sfidat për të ardhmen.***

Realizimi me sukses dhe në kohë i procesit të monitorimit kërkon angazhimin e një numri më të madh nëpunësish sesa ERRU ka aktualisht. Për këtë arsye Enti Rregullator i Ujit do të kërkojë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e institucioneve përkatëse për të mundësuar ndryshimin e organikës së saj.

• Standardet në sektorin UK

Një nga kompetencat kryesore të Komisionit Kombëtar Rregullator është inkurajimi i standardeve dhe rregullave uniforme për të gjithë sektorin, krijimi dhe garantimi i zbatimit të tyre nga të gjithë të licencuarit. Gjatë vitit 2014 Komisioni Kombëtar Rregullator ka ndërmarrë disa iniciativa në këtë drejtim, të cilat shkurtimisht janë paraqitur në vijim:

○ *Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm*

ERRU vlerëson si tepër të rëndësishëm procesin e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm që furnizohet për konsumatorët, informimin dhe mbrojtjen e tyre, si edhe raportimin dhe shkëmbimin e informacionit mes të gjitha hallkave të duhura institucionale lidhur me cilësinë e ujit. Cilësia e ujit të pijshëm në Shqipëri është një çështje mjaft e ndjeshme që lidhet direkt me standardin e shërbimit ujësjellës e kanalizime. Çdo papajtueshmëri me standardet bakteriologjike dhe klorin mbetës, përbën rrezik për shëndetin publik dhe ul besimin e konsumatorëve.

Në maj 2014, Enti Rregullator i Ujit, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik nënshkruan një marrëveshje mirëkuptimi, për raportimin dhe shkëmbimin e informacioneve mbi cilësinë e ujit të pijshëm që furnizon konsumatorët, nëpërmjet sistemeve të ujësjellësve. Kjo marrëveshje është produkt i një studimi të detajuar, i cili ka analizuar situatën mbi cilësinë e ujit, kuadrin ligjor, përgjegjësitë institucionale, dhe masat afatshkurtra dhe afatgjata që duhen marrë për të kontrolluar dhe monitoruar, në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt, cilësinë e ujit të pijshëm dhe shkarkimet e ujërave të ndotura.

Në vijim të kësaj Marrëveshje dhe në përmbushje të detyrimeve të ndërsjellta të përcaktuara në të, midis DRSH/DSHP-ve dhe Shoqërive UK u lidh një Akt Marrëveshje, ku u përcaktuan në detaje mënyrat sesi ato do të shkëmbejnë informacion dhe bashkëveprojnë në hartimin e planit për monitorimin e cilësisë së ujit dhe në marrjen e masave për eliminimin e rasteve të cilat nuk janë në konformitet me standardin e cilësisë së ujit të pijshëm.

ERRU me mbështetjen e GIZ ndërmori një sërë trajnimesh për personelin e DRSH/DSHP-ve dhe shoqërive UK mbi procedurat e monitorimit dhe formatit të ri të raportimit të cilësisë së ujit. Në fokus të këtyre trajnimeve ishin:

- Prezantimi i regjistrit të unifikuar të raportimit mbi cilësinë e ujit;
- Monitorimi i të dhënave të cilësisë së ujit;
- Plotësimi i formatit të ri të regjistrimit të testeve të cilësisë së ujit;
- Mënyra e raportimit mbi testet e bëra dhe rezultatet e dala nga ky monitorim.

Qëllimi i kësaj nisme është të rrisë dhe përmirësojë monitorimin e cilësisë së ujit, fillimisht duke u nisur nga zonat e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë nga shoqëritë, si edhe të unifikojë numrin dhe llojin e analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike në të gjithë vendin.

Në përfundim të trajnimeve ERRU nën mbështetjen e GIZ hartoi një raport mbi problematikën e laboratorëve dhe kapaciteteve lokale për të realizuar monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm të cilën ia vuri në dispozicion ISHP-së. Një nga problematikat kryesore ishte mungesa e laboratorëve dhe kiteve testues dhe metodave të vjetra të kryerjes së analizave. Në ndihmë të rritjes së kapaciteteve laboratorike GIZ investoi në blerjen e 4 laboratorëve të lëvizshëm për ISHP-në.

- ***Kontrata me konsumatorin***

Kontrata model e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime është miratuar nga ERRU në shkurt të vitit 2011.

Me qëllim zbatimin e kësaj kontrate u hartua plani i zbatimit për të gjithë operatorët e shërbimeve, të cilët brenda vitit 2011 duhet të nënshkruajnë këtë kontratë me të gjithë klientët privatë dhe buxhetor dhe deri në fund të vitit 2013 duhet ta përfundonin këtë proces me të gjithë klientët familjare.

Në fillim të vitit 2014 zbatimi në shkallë vendi i kontratës model ishte rreth 34 % për të gjithë klientët në total.

Duke patur parasysh të drejtën e konsumatorëve për të patur një shërbim cilësor si dhe nevojën për të drejta dhe detyrime të qarta, ERRU vendosi që prej muajit Shtator 2014, kontrata model të jetë një kontratë tip e cila rregullon detyrimisht të gjitha marrëdhëniet mes konsumatorëve dhe operatorëve të shoqërive UK në Shqipëri, pavarësisht nënshkrimit të saj ose jo nga palët.

- ***Verifikimi i matësve të ujit***

Në shtator të vitit 2014 Enti Rregullator i Ujit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nënshkruan një akt-marrëveshje bashkëpunimi mbi verifikimin e matësve të ujit për saktësinë dhe vulosjen e tyre. Enti Rregullator i Ujit duke pasur në vëmendje të veçantë mbrojtjen e konsumatorit, e konsideron matjen e ujit si një nga aspektet më të rëndësishme në ofrimin e këtij shërbimi.

Për këtë arsye ERRU e monitoron nivelin e matjes, si një nga treguesit kryesorë të performancës së shoqërive UK. Nga ana tjetër, bazuar në të dhënat e ankesave të konsumatorëve, cilësia e matjes është një aspekt problematik në ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë.

Sipas ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008 "Për metrologjinë", i ndryshuar, të gjithë operatorët, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, duhet të përdorin instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara, në

mënyrë që të sigurojnë saktësinë e kërkuar të matjeve. Ata janë përgjegjës për performancën teknike të instrumenteve matëse dhe për saktësinë e rezultateve të tyre.

ERRU dhe DPM për vitin 2015 do të bashkërendojnë punën për të siguruar dhe rregulluar përfundimisht shërbimin e verifikimit fillestar dhe periodik të saktësisë së matësve të ujit, duke shmangur mundësinë e abuzimit me të drejtën e konsumatorëve për t'u faturuar vetëm për sasinë e konsumuar.

1.4. Konsolidimi institucional

• Përmirësimi i instrumenteve rregullatorë

Një nga kompetencat e Komisionit Kombëtar Rregullator është miratimi i rregullave për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në ligj. Në këtë drejtim, ERRU gjatë vitit 2014 ka punuar për të përmirësuar instrumentet rregullatorë mbi të cilat bazohet puna e përditshme e ERRU, si më poshtë:

○ *Rishikimi i afateve të licencimit dhe marrjes së masave përkatëse*

Një nga funksionet kryesore të ERRU është licencimi i operatorëve të shërbimeve UK. ERRU nëpërmjet Rregullores së Licencimit dhe Kushteve të Licencës rregullon gjithë procesin e licencimit që nga hapi i parë i aplikimit, plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, marrjen e licencës si dhe monitorimin e kushteve të saj.

Me qëllim forcimin e aktivitetit rregullator, ERRU në muajin Dhjetor 2014, ka rishikuar hapat e ndjekur gjatë gjithë këtij procesi të përmendur më sipër, ka përcaktuar afate të qarta për çdo hap gjatë procedurës së licencimit, të shoqëruara këto me marrjen e masave përkatëse sipas ligjit.

Ky ndryshim është i nevojshëm për të rritur shkallën e përgjegjshmërisë së gjithë operatorëve të shërbimeve dhe shmangien e vonesave të panevojshme që çojnë në shkeljen e afateve të vlefshmërisë së Licencës.

○ *Modeli i aplikimit tarifor*

Enti Rregullator për Sektorin Ujësjellës Kanalizime që prej shtatorit 2011 ka një metodologji të vendosjes së tarifave për ujin e pijshëm dhe për ujërat e ndotura, e cila bazohet në disa elementë tekniko-financiar të kompanive si kostot operacionale dhe ato totale, por edhe në arritjen e objektivave të vendosur për treguesit e performancës së kompanisë.

Nën asistencën e GIZ, institucioni ynë e ka përshtatur modelin e aplikimit tarifor për të qenë më e lehtë për t'u plotësuar nga stafi teknik i shoqërive ujësjellës - kanalizime. Për paraqitjen e këtij modeli, u organizua dhe një takim me specialistë të 5 shoqërive ujësjellës-kanalizime

(Sarandë, Lushnjë Qytet, Lezhë, Fier, Krujë) dhe konsulentë lokalë të kompanisë mbështetëse të kontraktuar nga KFW.

Objekti i këtij takimi ishte diskutimi dhe mbledhja e sugjerimeve mbi rishikimin e modelit jo nga pikëpamja e logjikës së llogaritjes së tarifave por nga këndvështrimi i kuptimit dhe lehtësisë së përdorimit të këtij modeli.

Gjithashtu u prezantuan dhe dy manuale që i vijnë në ndihmë operatorëve. Manuali i parë ndihmon në justifikimin e nivelit të tarifës duke iu referuar masave që synon të ndërmerret operatori për të përmirësuar treguesit e performancës dhe manuali i dytë synon të ndihmojë në plotësimin e modelit të llogaritjes së tarifës për ujë të pijshëm dhe kanalizime.

Në përfundim u arrit në konkluzionin e përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve se ndryshimet dhe përmirësimet që i janë bërë modelit të aplikimit për ndryshim tarifash bëjnë që ky model të jetë më i qartë e më i përshtatshëm për t'u punuar nga operatorët.

○ **Koncepti i sistemit të raportimit rregullator**

Në Shqipëri ekziston nevoja për të ngritur një sistem efektiv të raportimit rregullator dhe të monitorimit të performancës.

Ky sistem do të çojë në monitorimin e vazhdueshëm të performancës financiare dhe operative të Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime, në mënyrë që ERRU të realizojë objektivat e saj të vendosura në ligj, të ketë një vendimmarrje sa më korrekte në lidhje me licencimin e operatorëve dhe vendosjen e tarifave si dhe të monitorojë arritjet e synuara të performancës të këtyre shoqërive apo të përdorë stimuj dhe/ose masa administrative për të arritur këto objektiva.

Monitorimi duhet të bazohet në të dhëna të sakta, të besueshme dhe të grumbulluara në kohë, të cilat do të mundësojnë një planifikim të mirë, një krahasim kuptimplotë të performancës së shoqërive, i cili rrjedhimisht të çon në një aktivitetet rregullator më efektiv.

Kuptohet që në radhë të parë, të dhënat e sakta e të besueshme janë të një rëndësie të veçantë për një mirë-menaxhim të vetë shoqërive dhe përmirësim të ofrimit të shërbimeve në sektor. Ky aspekt është i rëndësishëm të kuptohet nga të gjithë palët e interesuara në sektor, politikë-bërësit, investitorët, drejtuesit e shoqërive, qeverisja lokale, rregullatori dhe publiku i gjerë.

Gjithashtu, duke pasur parasysh zhvillimet në sektor gjatë këtyre viteve doli i nevojshëm dhe rishikimi i tregueseve të performancës që ERRU aktualisht përdor në vlerësimin e aplikimeve për tarifë dhe të performancës së Shoqërive Ujësjetllës-Kanalizime.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2014, ERRU në bashkëpunim me GIZ, ka nisur një projekt për krijimin e një "Sistemi të raportimit rregullator", ku është angazhuar eksperti ndërkombëtar, Z.

Enrique Cabrera, bashkëautor i manualeve të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA) për praktikat më të mira për indikatorët e performancës dhe benchmarking, në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime. Sistemi i cili do të përdoret për këtë raportim rregullator është SIGMA.

Në lidhje me këtë projekt janë zhvilluar një sërë aktivitete, që kanë ndikuar pozitivisht në ecurinë e tij. Baza e krijimit të sistemit rregullator ishte zbrëthimi i objektivave të ERRU-së që dalin nga ligji 8102 dhe nga strategjia ndërsektoriale 2011-2017, në kritere për t'u vlerësuar.

Kriteret më pas, u ndanë në tregues performance dhe më tej në të dhënat e nevojshme për të llogaritur e vlerësuar këta tregues. Gjatë këtij procesi u mor parasysh përdorimi i të njëjtës terminologji e metodikë me praktikat ndërkombëtare (indikatorët e IWA-s), qoftë në mbledhjen e të dhënave dhe qoftë në vlerësimin e tyre, në mënyrë që gjuha dhe termat e përdorur të jenë të njëjta në të gjithë sektorin.

Mënyra e vlerësimit të të dhënave që do të grumbullohen nga shoqëritë, do të bazohet në një klasifikim me 3 nivele sipas shkallës së besueshmërisë dhe saktësisë së llogaritjes së tyre, me qëllim që ato të jenë sa më të sakta dhe të matshme, jo vetëm për ERRU-në por dhe për aktorët e tjerë në sektor.

Ky proces do të vazhdojë dhe në 2015, e ndjekur nga trajnime jo vetëm të stafit të ERRU-së mbi sistemin SIGMA dhe përpunimin e të dhënave në këtë sistem, por dhe trajnime të stafit të Shoqërive UK mbi procedurat dhe mënyrat e grumbullimit dhe vlerësimit të të dhënave me qëllim që të dhënat e raportuara të jenë sa më të sakta e të besueshme. Sistemi do të jetë i aksesueshëm nga ndërmarrjet on-line dhe kushdo përdorues informacioni. Testimi paraprak i sistemit ka rezultuar pozitiv dhe të dhënat historike janë vendosur tashmë që nga viti 2008.

○ *Efiçenca e Energjisë*

Përmirësimi i efiçencës së energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës financiare të operatorëve ujësjellës-kanalizime.

Kostoja e energjisë si një ndër zërat kryesorë të kostos së shërbimit është një nga tematikat më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet sektori ujësjellës kanalizime dhe si vijim është në qendër të punës së ERRU-së e cila si pjese të objektivave të saj ka dhe qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

Që nga viti 2011, efiçenca e energjisë është pjesë e objektivave të vendosur për treguesit e performancës së kompanisë gjatë procesit tarifar që kryen ERRU në rast aplikimi për tarifë nga shoqëritë UK. Për më tepër, ERRU në kuadër të projektit mbi rishikimin e tregueseve të performancës, i ka dhënë një rëndësi akoma më të madhe menaxhimit të kostove të energjisë, duke e përfshirë atë në disa nën-tregues të performancës së shoqërive.

Megjithatë puna e ERRU-së në drejtim të menaxhimit të kostove të energjisë nuk është fokusuar vetëm në vendosjen e objektivave për shoqërinë, por dhe në dhënien e sugjerimeve apo mbështetjen e tyre në mënyrat sesi të orientohen përkundrejt menaxhimit të këtij indikator. Gjetja e rrugëve të duhura dhe dhënia e nxitjeve në orientim të reduktimit të kostos së energjisë elektrike është një nisme tjetër e ERRU-së, e nisur gjatë 2014 dhe synim për vitin në vazhdim.

Me marrjen e kësaj nisme, si fillim u pa e nevojshme njohja më mirë e situatës së gjithë shoqërive UK, dhe jo vetëm të atyre që aplikojnë për tarifa. Për më tepër, u vlerësua i rëndësishëm dhe fakti se si dhe sa shoqëritë i vlerësojnë kostot e energjisë elektrike dhe masat aktuale organizative që ato marrin në lidhje me reduktimin e tyre.

Për këtë qëllim u përgatit një pyetësor i detajuar që ju dërgua të gjitha shoqërive UK, kryesisht i bazuar në:

- sistemet e matjes së energjisë dhe të dhëna të përgjithshme mbi to;
- masat organizative për efikasitetin e energjisë;
- planifikimi në aplikimin e efikasitetit të energjisë dhe menaxhimi i kostove;

Rezultatet e këtyre pyetësorëve do të përpunohen në vijim nga stafi i ERRU-së, për të dalë me një raport mbi situatën aktuale të shoqërive dhe problematikat përkatëse, për të kaluar më pas në rekomandime specifike për çdo shoqëri në lidhje me mënyrat e vlerësimit të kostove të energjisë dhe menaxhimit të tyre.

• **Bashkëpunimi me aktorët në sektor**

Enti Rregullator i Ujit ka si mandat të tij, krijimin e një sektori UK financiarisht të qëndrueshëm që i ofron të gjithë klientëve shërbime me cilësi të lartë, por dhe të përballueshme financiarisht.

Në funksion të këtij qëllimi, prioritet merr krijimi i një fryme pozitive bashkëpunimi me institucionet në vend edhe ato ndërkombëtare, veprimtaria e të cilave lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin rregullator

○ **Bashkëpunimi me qeverisjen qendrore**

Përgjatë vitit 2014, në kuadër të dialogimit për përmirësimin e vazhdueshëm të sektorit jetik të ujësjellës kanalizime, ERRU ka pasur një bashkëpunim mjaft mirëkuptues e të vazhdueshëm me Kuvendin e Shqipërisë, përkatësisht me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, me Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore, etj.

○ ***Bashkëpunimi me shoqëritë UK dhe pronarët e tyre***

ERRU deri më sot ka ushtruar mandatin e vet duke ofruar bashkëpunim dhe ndihmën e tij për të gjithë shoqëritë UK që operojnë në sektor. Qëllimi madhor i ERRU ka qenë rregullimi i të gjithë shoqërive, si në lidhje me licencimin e tyre duke u përpjekur që ti përfshijë ato nën kuadrin rregullator, ashtu edhe në drejtim të politikës tarifore. Bazuar mbi këtë, e gjithë filozofia e punës së ERRU ka qenë e fokusuar drejt mbështetjes, bashkëpunimit, ndihmës ndaj operatorëve, me qëllim mbulimin e kostove dhe rritjen graduale të cilësisë së shërbimit.

Në këtë aspekt, ERRU duke njohur dhe situatën në terren, kushtet e operimit, vështirësitë që kanë hasur dhe hasin shoqëritë në mbështetjen jo efikase nga ana e Këshillave Mbikëqyrës, si dhe duke ndjekur vazhdimisht punën e çdo shoqërie, nuk është orientuar drejt përdorimit të masave administrative si mjet për të shtrënguar shoqëritë në punën e tyre.

Në ushtrimin e mandatit të vet rregullator, ERRU ka nevojë për një bashkëpunim të gjithë institucioneve në sektor, duke e pasur të pamundur të veprojë i shkëputur:

○ Në ushtrimin e funksionit të licencimit i nevojitet bashkëpunimi i njësisve vendore, jo vetëm për marrjen e licencës por dhe gjatë monitorimit të kushteve të licencimit. Gjithashtu i nevojitet dhe mbështetja e qeverisjes qendrore për të përcaktuar politika e strategji për t'u ndjekur, në rastet kur ERRU gjatë monitorimit të shoqërive vëren shkelje të kushteve të licencës që mund të çojnë në revokimin e saj;

○ Në funksionin e përcaktimit të tarifave i nevojitet bashkëpunimi i njësisve vendore në lidhje me aprovimin e ndryshimeve për tarife, përpara se shoqëria të paraqesë këtë kërkesë pranë ERRU-së. Gjithashtu, edhe i qeverisjes qendrore përsa i përket informimit në lidhje me nivelin e subvencioneve dhe investimeve, në mënyrë që ERRU t'i ketë ato parasysh gjatë vlerësimit të tarifës.

Në këtë panoramë, duhet të theksojmë se janë operatorët e shërbimeve UK që në radhë të parë, kanë problematika në raport me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të tyre. Organet e këtyre shoqërive siç janë këshillat mbikëqyrës dhe asambleja e aksionerëve shpesh nuk mbledhen për të marrë vendimet përkatëse, duke penguar punën e operatorëve.

Gjithashtu, njësitë vendore që janë pronarët e këtyre operatorëve, në shumë raste qëndrojnë tërësisht indiferentë ndaj zhvillimeve në sektorin UK, dhe nuk ndiejnë përgjegjësinë që ju takon sipas ligjit. Ky fenomen vihet re veçanërisht në ato shoqëri (operatorë) të cilat janë në bashkëpronësi mes dy ose më shumë njësisve vendore.

Kjo situatë ka krijuar pengesa të vazhdueshme në punën e ERRU, qoftë për licencimin, qoftë për marrjen e masave të tjera administrative ndaj operatorëve.

○ ***Bashkëpunimi me Donatorët***

Drejtimet kryesore ku fokusohet bashkëpunimi ynë me institucionet ndërkombëtare janë bashkëpunimi me donatorët që japin kontributin e tyre në sektorin e ujit në Shqipëri,

shkëmbimi i eksperiencave me rregullatorët homologë si dhe sigurimi i një roli aktiv si anëtarë në organizata ndërkombëtare në fushën e ujit.

Ndaj, edhe gjatë vitit 2014, ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me GIZ si një partner serioz dhe një faktor mbështetës shumë i rëndësishëm për ngritjen institucionale të ERRU-së.

Gjithashtu një bashkëpunim i rëndësishëm ka qenë me Bankën Botërore në kuadër të Programit të Danubit për shërbimet e ujit, shoqatën e Vendeve të Danubit, USAID dhe DLDP në kuadër të një sërë projektsh të përbashkëta, etj.

ERRU vijon të ketë një bashkëpunim të frytshëm në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave rregullatore me Zyrën Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim në Kosovë, (ZRRUK) dhe Entin Rregullator të Shërbimeve të Ujit dhe Mbetjeve të Portugalisë, ERSAR.

Enti Rregullator i Ujit është anëtarë me të drejta të plota në Shoqatën Ndërkombëtare të Ujit (IWA), ku ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara prej saj. ERRU është një nga institucionet bashkëthemeluese të Rrjetit të Rregullatorëve të Ujit (WAREG) në Maj të vitit 2014, si dhe ka pasur një bashkëpunim të ri dhe mjaft të ngushtë me Shoqatën Rregullatore Rajonale të Energjisë, tashmë e fokusuar edhe në çështjet e ujit.

Gjithashtu ka vijuar bashkëpunimi me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, OECD, si pjesë e rrjetit të rregullatorëve ekonomik në Europë. Në Nëntor 2014 si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi OECD përfshin edhe Shqipërinë në raportin e saj të rregullatorëve dhe performancës së tyre në fushën e ujit (ndër 31 vende të marra në studim). Për herë të parë Shqipëria e gjen veten ku është në funksionet rregulluese kundrejt vendeve më të zhvilluara në Evropë dhe mbarë botën. Ky studim ndihmoi ERRU të mirë argumentonte sugjerimet ligjore në ligjin 8102/1996.

1.5. Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU-së


• Burimet e financimit të veprimtarisë së ERRU-së

Si institucion i pavarur që nuk financohet nga buxheti i shtetit, ERRU mbulon të gjitha shpenzimet për ushtrimin e veprimtarisë me të ardhurat që realizon nga pagesat rregullatore ku hyjnë pagesat për tarifën, pagesat për licencimet dhe donacionet. Për vitin 2014, të ardhurat totale të realizuara janë 50.707.204 lekë që të analizuara sipas burimeve të financimit janë:

- 50.127.204 lekë nga pagesat për tarifën,
- 580.000 lekë nga pagesat për licencimet.

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2014, është miratuar me VKM nr. 1034, datë 27.11.2013, "Për miratimin e planit të shpenzimeve të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për vitin 2014" Ky plan për vitin 2014 është në shumën 39.520.000 leke, i detajuar si më poshtë:

Grafiku 6. Plani Vjetor i Shpenzimeve Operative




Edhe këtë vit ERRU ka përfituar financime nga projekti i GIZ për disa aktivitete e veprimtari, ku kryesisht mund të përmendim aktivitete në kuadrin e bashkëpunimit e shkëmbimit të eksperiencave me institucione të huaja ndërkombëtare, botimi i raportit të performancës, trajnime të ndryshme etj. Gjithashtu me mbështetjen financiare të GIZ, u mundësua dhe instalimi i teknologjisë inovative (server, pajisje kompjuterike, ups, etj) të domosdoshme për realizimin e Sistemit të Raportimit Rregullator, duke rritur aktivitet e ERRU-së me vlerë mbi 4.5 milion lekë.

- **Shpenzimet operative**

Përdorimi i fondeve të planifikuara për trajtimin me paga e shpërblime të punonjësve është bërë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe ai për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme është kryer në përputhje e në zbatim të plotë me ligjin “Për prokurimet publike”. Po kështu është ndjekur në vazhdimësi edhe përmbushja e detyrimeve kontraktuale për këto mallra dhe shërbime, duke kryer njëkohësisht edhe pagesat përkatëse.

Grafiku 7. Realizimi Vjetor i Shpenzimeve krahasuar me Planin



Zëri paga e shpërblime është realizuar në masën 85.59% të fondit të planifikuar, ndërsa sigurimet shoqërore në masën 101.6%. Diferenca në këtë mosrealizim vjen kryesisht si rezultat i mosplotësisht mesatarisht për një periudhe njëvjeçare të pozicionit të një anëtarit të KKRR. Tejkalmimi në zërin sigurime shoqërore është rezultat i ndryshimit të masës mbi të cilën

përlllogaritet sigurimi shëndetësor për të gjithë punonjësit dhe sigurimi shoqëror për një pjesë të tyre. Fondi i planifikuar në zërin “Shërbime e furniturë” është realizuar në masën 84.16%. Shpenzimet në zërin investime janë realizuar në masën 32.7% të planit. Në planin vjetor të investimeve janë parashikuar fonde për ristrukturimin e disa zyrave që duhet të merreshin gjatë vitit, por duke qenë se kjo nuk u realizua, fondet e parashikuara nuk u përdoren dhe aktualisht ERRU vazhdon të ushtrojë veprimtarinë në ambiente të pamjaftueshme.

• Pagesat rregullatore për vitin 2014

Në vitin 2014, duke u nisur nga problematika e krijuar me pagesat rregullatore nga tarifat të pashlyera në dy vitet e fundit dhe faktit që këto përbëjnë më shumë se 97% të gjithë të ardhurave të rregullatorit, ERRU i ka kushtuar një vëmendje të veçantë likuidimit të këtyre detyrimeve nga shoqëritë. Grupi i punës i krijuar për ndjekjen e kësaj problematike, pas një sërë analizash të kryera në lidhje to, sugjeroi uljen e pagesave rregullatore për tarifat të operatorëve në masën 30%, duke synuar përafrimin e tyre me nevojat vjetore për buxhet të ERRU-së si dhe lehtësimin ekonomik të operatorëve. Si rezultat i punës së gjithanshme të kryer në vitin 2014, likuidimet u rritën ndjeshëm duke arritur në shumën 50.127.204 lekë, ose 110.4 % e detyrimit vjetor të kontraktuar. Likuidimet e vitit 2014, janë mbi dyfish më të larta në krahasim me likuidimet e vitit 2013, ku u arkëtuan nga operatorët vetëm 20.405.249 lekë.

Grafiku 8: Ecuria e arkëtimeve nga pagesat rregullatore në vite (në mijë lekë)



Por, nëse analizohet vlera e likuiduar sipas viteve të krijimit të detyrimit, këtë vit për llogari të detyrimeve të vitit janë likuiduar vetëm 9.066.420 lekë, ndërsa vlera më e madhe prej 40.970.784 lekë është për llogari të viteve të mëparshme. Në fund të vitit 2014 pagesat rregullatore të pashlyera rezultojnë në shumën 85.049.414 lekë.

Mospagimi në kohë i pagesave rregullatore nga shoqëritë, çon në mbartjen e detyrimeve kontraktuale nga viti në vit, gjë që krahas problemeve që krijon për rregullatorin, vështirëson edhe më shumë gjendjen ekonomike të vetë shoqërive. ERRU vazhdimisht ju ka bërë me dije shoqërive detyrimet e tyre ligjore, duke tërhequr herë pas here vëmendjen në këtë drejtim. Gjithashtu gjatë këtij viti janë bërë përpjekje konkrete për të ndjekur rrugën gjyqësore për likuidimin e pagesës rregullatore duke paditur në gjykatën administrative dy prej shoqërive UK.

1.6. Rregullimi për vitin 2015

ERRU do të vazhdojë të ushtrojë mandatin e tij ligjor, nga njëra anë për të mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe nga ana tjetër për të zgjeruar mjedisin rregullues në sektorin ujësjellës kanalizime në përgjithësi.

Viti 2015 do të shënojë vendimmarrje të rëndësishme nga ana e politike-bërësve në lidhje me organizimin e ri territorial, organizimin e funksionimit të sektorit UK dhe funksionet e njëjësive të reja të qeverisjes vendore.

ERRU do të vazhdojë të bashkëpunojë me qeverisjen qendrore për realizimin e këtyre reformave të suksesshme në sektorin e ujësjellës kanalizime. Në kuadër të reformës së re territoriale dhe ristrukturimit të sektorit, ERRU do të mbështesë gjithashtu dhe zonat e reja administrative, në mënyrë që të sigurohet një mbulim total me shërbim ujësjellës e kanalizime i rregulluar, në të gjithë vendin. Në këtë drejtim ERRU ka filluar të punojë mbi rishikimin e formave dhe procedurave të licencimit të tyre, duke pasur parasysh dhe kushtet teknike të përshatshme për operatorët e rinj që do të krijohen.

Gjithashtu, gjatë këtij viti ERRU pritet të marrë dhe një funksion të ri, atë të vendosjes së tarifave për mbetjet.

ERRU do të vazhdojë të përmbushë objektivat e tij të përcaktuar në ligj gjatë viteve në vazhdim, duke u fokusuar në:

- i. Miratimin e licencave, monitorimin e kushteve të licencimit dhe përmirësimin e kuadrit rregullator përkatës;
- ii. Analizën e ndryshimeve për tarifë, miratimin dhe monitorimin e tyre;
- iii. Monitorimin e sektorit në përgjithësi, mbledhjen e të dhënave dhe verifikimin e tyre, inspektimet, analizat, krahasimet bazuar në tregues performance të mirëpërcaktuar;
- iv. Përmirësimin e instrumenteve rregullatore të përdorur, qoftë në mbrojtje të konsumatorit ashtu edhe në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të operatorëve;
- v. Bashkëpunimin me qeverisjen qendrore dhe atë vendore në lidhje me çështje specifike;
- vi. Rishikime dhe sugjerime pranë politike-bërësve për përmirësime në politika, strategji, rregullore e standarde;
- vii. Zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve kur ato paraqiten pranë ERRU-së.

Duke pasur parasysh këto objektiva e sfida të reja që sjell viti 2015, si dhe kufizimet në numër në stafin profesional të ERRU-së, lind nevoja emergjente për të rritur numrin e kapaciteteve teknike dhe përmirësimin e infrastrukturës së ERRU-së.

ERRU duke vlerësuar mbështetjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, me Këshillin e Ministrave dhe strukturave të tjera të qeverisë në përgjithësi, kërkon dhe shpreson në një mbështetje akoma më të madhe gjatë vitit 2015 për të përballuar këto sfida me sukses.

2. Gjendja në sektorin ujësjellës-kanalizime

2.1. Forma e administrimit të sektorit

- **Organizimi i sektorit UK**

Sipas ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, shërbimet ujësjellës e kanalizime janë funksion i njësive vendore (neni 10). Qeverisja qendrore përcakton politikat e zhvillimit dhe standartet e shërbimit, të punës, investimet, etj. Sektori i shërbimeve UK funksionon kryesisht nëpërmjet operatorëve të organizuar si shoqëri aksionare me pronar pushtetin vendor. Pas miratimit të ligjit nr. 8652, sistemet e furnizimit me ujë filluan të transferohen te njësitë vendore, nëpërmjet disa vendimeve të Këshillit të Ministrave të viteve 2004 dhe 2006.

Vendimi më i rëndësishëm dhe që përmbylli transferimin e aksioneve të operatorëve UK nga qeveria qendrore drejt njësive vendore ishte vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 660 datë 12.09.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore". Me këtë vendim 47 operatorë shërbimesh UK kaluan pranë njësive vendore përkatëse. Në rastet kur shoqëria UK mbulonte më shumë se një njësi të qeverisjes vendore, aksionet e saj u ndanë në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë të secilës njësi.

Problematikat që shoqëruan këtë proces bënë që transferimi efektiv i të gjithë operatorëve pranë njësive vendore të zgjatej në kohë duke krijuar vështirësi reale në ofrimin e shërbimit, si dhe duke nxjerrë në pah vakumin ligjor, përsa i përket rasteve të keqmenaxhimit të shoqërive.

Ndër këto problematika mund të përmendim:

- mungesën e dakortësisë me njësitë vendore për formën dhe mënyrën e transferimit të operatorëve,
- transferimi në bllok i operatorëve, pa analizuar situatën e secilit operator,
- mospasja parasysh e aseteve, sistemeve dhe skemave të secilës njësi vendore gjatë transferimit të tyre, regjistrimi jo korret i aseteve, etj.
- ekzistenca e një fragmentarizmi të madh i shërbimeve, për shkak të organizimit aktual të territorit.

Reforma administrative e miratuar së fundmi është një hap tepër i rëndësishëm për sektorin UK. Kjo reformë do të sjellë riorganizimin e shoqërive sipas hartës së re të organizimit të territorit, duke krijuar të gjitha kushtet për një menaxhim më të mirë, sipas parimeve të rajonalizimit dhe ekonomisë së shkallës. Gjithashtu kjo reformë eliminon disa fenomene negative që ndikojnë në sektor, si fragmentarizmi i shërbimeve, numrin e lartë të bashkëpronarëve në shumë shoqëri të shërbimit UK, etj.

• Ligji për sektorin UK

Sektori i shërbimeve UK është ndoshta sektori i vetëm në Shqipëri që nuk ka një ligj bazë i cili të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij, por aktualisht funksionon mbi bazën e disa akteve ligjore e nënligjore direkte (mbi 10 ligje e akte nënligjore që merren me problemet e menaxhimit të ujërave) dhe një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore të cilat ndikojnë indirekt në sektor.

Kjo sjell një sërë problematikash ku ndër të tjera mund të permendim:

- Të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbimin në sektorin ujësjelles kanalizime janë të paqarta;
- Të drejtat dhe detyrimet e institucioneve publike të përfshirë në këtë sektor kanë mbivendosje kompetencash ose këto kompetenca janë të paqarta;
- Mungon një model i zhvillimit të tregut, i cili duhet të ndiqet dhe një mirë-përcaktim të rregullave për funksionimit të tij.

*Për krijimin e një kuadri të plotë ligjor në sektor i cili do të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë si dhe të institucioneve publike të përfshirë në këtë sektor, modelin e tregut, rregullat e funksionimit të tij, etj, do të ishte i nevojshëm **krijimi i një ligji specifik për sektorin.***

Një praktike e tillë ndiqet dhe në shumë vende të tjera europiane, po jo vetëm. Sektorë të tjerë në Shqipëri si psh ai i energjisë, komunikimeve elektronike, shërbimi postar, shërbimi bankar, etj, kanë një ligj specifik për sektorin, ku pjesë e tij është dhe kuadri rregullator.

Ky ligj do të integronte dhe do të harmonizonte të gjitha aktet e shpërndara në kohë dhe do të shmangë paqartësitë, dykuptimësitë dhe interpretimet e ndryshme.

• Pronësia e aseteve

Pronësia e aseteve të sistemeve ujësjellës e kanalizime është pjesa më delikate e sektorit UK. Këto asete janë transferuar në mënyrë graduale me vendime të ndryshme të Këshillit të Ministrave pranë njësive vendore, në zbatim të reformave të decentralizimit dhe të funksioneve të NJQV, sipas ligjit për qeverisjen vendore.

Eksperiencat e deritanishme tregojnë se ekziston një mungesë e theksuar dokumentacioni përsa i përket aseteve të sistemeve të ujësjellës kanalizimeve. Regjistrat e aseteve të shoqërive UK nuk përditësohen periodikisht për të përfshirë si inventarin vjetor të aseteve, ashtu edhe çertifikimin e tyre në Zyrën së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Nga ana tjetër rezultojnë se asetet e përfituara nga investimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore si aksionare të shoqërive UK, nuk janë pjesë e inventarit të sistemeve UK të këtyre shoqërive.

Gjithashtu, njësitë e qeverisjes vendore që nuk janë pjesë e juridiksionit të shoqërive UK, kanë ndërtuar sistemet e tyre të furnizimit me ujë, për të cilat aktualisht nuk ka informacion, çka do të thotë që ende nuk dihet se sa sisteme individuale ka në funksion, cilat janë elementet përbërëse të tyre, etj. Kjo situatë vijon të jetë në ngërç.

Për zgjidhjen e problematikave të mësipërme është i nevojshëm krijimi i politikave mbi menaxhimin e asetëve dhe strategjisë përkatëse mbi hapat sesi do të arrihen objektivat e politikës duke përcaktuar përgjegjësitë për menaxhimin e zbatimit të saj, si dhe përshtatja e planit të veprimit të përcaktuar në strategji, për të siguruar një zbatim efektiv të menaxhimit të asetëve.

• Llogaridhënia

Llogaridhënia mbi shërbimin UK është një tjetër pikë delikate e sektorit UK. Shoqëritë UK kryejnë një shërbim publik, jetik, që për nga natyra është monopol. Ofrimi i shërbimit për të gjithë konsumatorët kërkon edhe disa standarde dhe disa objektiva të qarta për të përmirësuar performancën e çdo shoqërie.

Shoqëritë UK duhet në radhë të parë të përgjigjen përpara njësisve vendore që janë pronari i tyre, mbi gjendjen e shërbimit dhe punën e kryer. Njësitë vendore kanë mundësinë të jenë më aktive në këtë aspekt, duke rritur kërkesën e tyre ndaj shoqërisë. Megjithatë, sikundër kemi përmendur më lart, njësitë vendore shpesh nuk i kuptojnë përgjegjësitë e tyre në raport me këtë shërbim, edhe pse janë pushteti më afër qytetarit. Në këtë drejtim, një rol mjaft të rëndësishëm mund të luajë kryetari i njësisë vendore.

Institucioni i Kryetarit të NJQV deri më sot është në një pozitë periferike për sa i përket menaxhimit të shoqërisë. Të gjitha kompetencat mbi shoqërinë ushtrohen nga këshillat vendore. Ndërkohë, edhe pse Kryetari i NJQV-se zgjidhet direkt nga banorët për të drejtuar punët e njësisë, roli i tij në funksionin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime është i zbehtë.

Në kuadër të reformës administrative dhe paketës së re të decentralizimit, roli i kryetarit të NjQV duhet të rishikohet për të qenë më aktiv në drejtim të menaxhimit të brendshëm të shoqërisë dhe në punën e shoqërisë. Gjithashtu, paketa e decentralizimit duhet të përcaktojë qartë edhe mënyrën e riorganizimit të shërbimeve UK si funksion i njësisve të reja vendore, për të shmangur çdo paqartësi. Një nga opsionet e riorganizimit të sektorit që sugjeron një bashki, një shoqëri UK, do të zgjidhte problemin e llogaridhënies së drejtuesit të shoqërisë kundrejt pronarit si edhe do të zgjeronte mbulimin me shërbim.

2.2. Mbulimi me shërbime ujësjellës e kanalizime


Enti Rregullator i Ujit bën përpjekje maksimale që shërbimi ndaj konsumatorëve të jetë gjithnjë e më cilësor, i ofruar nga operatorë të licencuar, me tarifa të miratuara prej tij, duke patur gjithnjë në vëmendje konsumatorin.

Mbulimi me shërbime ujësjellës - kanalizime përfaqëson numrin total të popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit të shoqërive UK dhe i përfiton këto shërbime nga shoqëria.

Ky mbulim sigurohet nga 57 operatorë, nga të cilët:

- **4 (katër)** operatorë kryejnë shërbimet e furnizimit me ujë, grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura si dhe shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura;
- **28 (njëzet e tetë)** operatorë ofrojnë të dy shërbimet, atë të furnizimit me ujë dhe grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura;
- **25 (njëzet e pesë)** operatorë ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë, ndërsa shërbimi i largimit të ujërave të ndotura kryhet nga vet njësitë e qeverisjes vendore, të cilat kanë filluar të kalojnë këtë shërbim pranë shoqërive UK.

Grafiku 9. Ndarja e operatorëve sipas shërbimeve që ato kryejnë



*Mbulimin me shërbimin e furnizimit me ujë nga shoqëritë UK e përfitojnë vetëm **81% e popullsisë në zonën e tyre të juridiksionit**, raport ky i cili nuk ka ndryshuar as këtë vit.*

*Përsa i përket shërbimit të grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura, ai ofrohet nga shoqëritë UK vetëm për **51% te popullsisë**. Për pjesën tjetër të popullsisë, ky shërbim kryesisht kryhet nga njësitë e qeverisjes vendore të cilat nuk e kanë transferuar atë pranë shoqërive të ujësjellësit në varësi të njësisë përkatëse.*

*Cilësia e shërbimit me kanalizime është përmirësuar ndjeshëm vetëm për **10 % të popullsisë** në zonën e juridiksionit të operatorëve si rezultat i vënies në punë të 5 impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura që priten të pasohen edhe nga impiante të tjerë që janë në ndërtim e në projektim.*

Popullsia që jeton në zonat urbane ka më shumë akses në shërbimin e furnizimit me ujë dhe grumbullimin e largimin e ujërave të ndotura të ofruar nga shoqëritë UK, (76% e mbulueshmërisë në furnizimin me ujë dhe 98% në shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura i përket zonës urbane), ndërsa ajo rurale ka akses kryesisht vetëm në furnizimin me ujë (24% e mbulueshmërisë në furnizimin me ujë dhe vetëm 2% në shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura i përket zonës rurale).


Pavarësisht se vetëm për 81% të popullsisë në zonën e juridiksionit të shoqërive UK shërbimi ofrohet nga këto shoqëri, ekziston dhe një pjesë tjetër e popullsisë e cila është jashtë zonave të juridiksionit të tyre (Aneksi 4), për të cilat Enti Rregullator i Ujit në nëntor të vitit 2013 nisi një studim kombëtar mbi shërbimin UK të ofruar në këto zona, i cili përfundoi në vitin 2014.

Studimi përfshiu evidentimin e zonave jashtë juridiksionit të shoqërive UK, të cilat përfshinin 131 njësi të qeverisjes vendore në të 12 Qarqet e Shqipërisë.

Për këtë pjesë të popullsisë, shërbimi ofrohet nga sektorë që veprojnë brenda njësive të qeverisjes vendore, komunave dhe bashkive përkatëse. Për realizimin e këtij studimi u përdor një pyetësor sasior dhe intervista gjysmë të strukturuar, me përfaqësues të njësive dhe personat përgjegjës për ofrimin e shërbimit. Të dhënat u analizuan me metodën analitike duke përdorur grafikë, të cilët interpretohen.


Duke përfshirë dhe të dhënat e marra nga ky studim, faktikisht zona e pambuluar me shërbim nga shoqëritë UK është rreth 30% e popullsisë së raportuar.

Grafiku 10. Zona e mbulueshmërisë me shërbim nga shoqëritë UK



Nga studimi i zonave jashtë juridiksionit të shoqërive UK rezultoi se popullsia totale në këto zona është 546,046 banorë, ku vetëm 64% e tyre përfitojnë nga shërbimi i furnizimit me ujë dhe 28% kanë akses në shërbimet e kanalizimeve, të ofruara nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore. Infrastruktura mungon ndjeshëm, veçanërisht sa i takon shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.

Grafiku 11. Popullsia në zonat e pambuluara që përfiton shërbimet ujësjellës dhe kanalizime



Përgjegjësia kryesore në këtë situatë mbetet e njësive të pushtetit vendor, të cilat duhet të ushtrojnë detyrimin ligjor të ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura dhe monitorimit të tyre. Kjo kërkon gjetjen e burimeve të financimit, të cilat duke qenë në një nivel të ulët nga ana e buxhetit të shtetit, duhet të krijojë nxitjen për sigurimin e projekteve nga donatorët.

Në kushtet e miratimit të reformës së re territoriale, shumë njësi të pushtetit vendor do të reduktohen për të krijuar njësi më të mëdha. Kjo reforme lehtëson mjaft çështjen e rregullimit ligjor të zonave të pambuluara, pasi mjaft njësi do të bëhen pjesë e bashkive/komunave më të mëdha.

ERRU do të mbështesë njësitet e reja të pushtetit vendor me qëllim që dhe këto njësi aktualisht jashtë juridiksionit të shoqërive ekzistuese UK, të përfshihen në sistemet e tyre të monitorimit dhe të bëhen pjesë e rregullimit.

2.3. Kostot për shërbimet ujësjellës e kanalizime

ERRU ka përzgjedhur treguesit e performancës "Mbulimi i kostos O&M" dhe "Mbulimi i Kostos Totale" për të vlerësuar situatën ekonomike të çdo shoqërie dhe sektorit në përgjithësi.

Mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes pasqyron se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij.

Në vitin 2014, mbulimi i kostove O&M me të ardhurat e realizuara është 114% dhe numri i shoqërive që mbulojnë 100% koston e operimit dhe mirëmbajtjes ka shkuar në 21 (njëzet e një).


Megjithëse rezultatet tregojnë për një ecure të mirë të sektorit, ka ende operatorë, kryesisht **operatorë të vegjël**, që nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë me të ardhurat e tyre. Vazhdimësia e aktivitetit të tyre mbështetet nga subvencionimi i buxhetit të shtetit.

ERRU e konsideron mbulimin e kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen.

Për vitin 2014, mesatarja e mbulimit të kostos totale për sektorin është 85%. Nëntë operatorë kanë arritur të mbulojnë me të ardhurat e tyre të gjitha shpenzimet e kryera për shërbimet e ofruara. Kryesisht janë shoqëritë e mëdha ato që kanë arritur këtë rezultat.

Niveli i arritur i këtij treguesi dhe tendenca e tij tregojnë se sektori UK është duke rritur gradualisht mbulimin e kostos totale.

Grafiku 12. Mbulimi i kostove me të ardhura (ne %)




Mbulimi i kostove është i lidhur ngushtë me realizimin e të ardhurave dhe kostot e shërbimit. Analiza e strukturës së kosto bën të mundur të përcaktohet për çfarë është shpenzuar më shumë, cilat janë arsyet, si dhe ku duhet të përqendrohen përpjekjet për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve.

*Një nga drejtimet kryesore të kryerjes së një shërbimi efektiv është **përmirësimi i efijencës operationale me qëllim uljen e kostove të shërbimit**. Përqindjen më të madhe në totalin e kostove e zënë kostot e personelit, energjisë elektrike dhe amortizimit, prandaj edhe përpjekjet e shoqërive duhet të përqendrohen për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve.*

Përgjithësisht operatorët UK kanë **numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje** që tregon për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Për vitin 2014, niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 8.9 punonjës/1000 lidhje. Për një numër të vogël operatorësh, niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje nuk është më shumë se 4-5 punonjës/1000 lidhje.

Grafiku 13. Struktura e kostos së shërbimeve UK për vitin 2014.



Pas kostove të personelit, **kostot e energjisë elektrike** janë ato që zënë një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove. Për operatorët që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, efijenca e energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në këtë zë të shpenzimeve.

Ulja e kostos së energjisë elektrike për shërbimin e furnizimit me ujë është e lidhur edhe me përmirësimin e disa treguesve të tjerë si reduktimi i humbjeve, vendosja e matësve por edhe me një menaxhim më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë, të cilat sjellin uljen e vëllimit të ujit të prodhuar dhe për rrjedhojë edhe ulje të konsumit të energjisë. Shpenzimet për energjinë

elektrike janë rritur edhe për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos për ata operatorë që administrojnë edhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Krahas këtyre shpenzimeve edhe **shpenzimet për mbulimin e amortizimit** zënë një pjesë të rëndësishme në totalin e kostove. Investimet e kryera në sektorin UK kanë si burim financimi kryesisht buxhetin e shtetit, donacionet dhe kreditë. Për shoqëritë të cilat burimi i financimit të investimeve janë kreditë, kosto e kredisë është shtesë në koston totale. Hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve do të bënte të mundur uljen e këtyre kostove.

Në sektorin ujësjellës kanalizime janë kryer dhe po vazhdojnë të kryhen investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve apo ndërtimin e sistemeve të reja. Mbështetësit kryesorë për financimin e investimeve mbeten fondet e akorduara nga buxheti i shtetit si dhe kreditë dhe grantet nga donatorët e huaj. **Mirëmbajtja e këtyre investimeve si dhe pagesat për koston e kredive për shumë operatorë**, zënë një vend të rëndësishëm në totalin e koston, prandaj edhe sigurimi i mjeteve financiare për mbulimin e tyre merr një rëndësi të veçantë.

Një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet **edhe rritjes së të ardhurave**. Jo vetëm rritja e tarifave, por edhe faturimi i të gjithë klientëve në zonën e shërbimit, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, ndërgjegjësimi i konsumatorëve për të paguar për shërbimet e ofruara bëjnë të mundur rritjen e të ardhurave.

Megjithatë edhe gjatë vitit 2014 qeveria ka akorduar subvencione, për mbulimin e kostove operacionale të shoqërive ujësjellës kanalizime. Këto subvencione po vijnë duke u ulur nga një vit në tjetrin. Ky është një sinjal që operatorët duhet të sigurojnë pavarësinë ekonomike dhe të realizojnë të ardhurat për përballimin e shpenzimeve.

Tabela 1. Mbulimi i kostove për tre grupet e operatorëve:

	Madhësia e operatorit (nr i lidhjeve ujësjellës)	% e popullsisë së shërbyer	Mbulimi Kostove O&M	Mbulimi i Koston Totale
Grupi 1	>15.000	76%	125.00%	93.20%
Grupi 2	3.000 - 15.000	17%	85.00%	66.50%
Grupi 3	<3.000	7%	64.30%	45.60%

Mbulimi i kostove mbetet një problematikë për shoqëritë e vogla, të cilat nuk janë në gjendje të sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit pa ndihmën e subvencioneve. Pjesa më e madhe e këtyre shoqërive operojnë në zona ku të ardhurat për familje janë të ulta dhe rritja e mëtejshme e tarifave me qëllim mbulimin e kostove O&M nuk do të ishte e përbalueshme nga konsumatorët. Ndërsa për pjesën më të madhe të shoqërive të grupit të dytë është më lehtë të arrihet mbulimi i kostove O&M nëpërmjet rritjes së tarifave dhe përmirësimit të treguesve.

ERRU do të vazhdojë nxisë dhe mbështesë shoqëritë UK që bëjnë përpjekje për të përmirësuar efikasitetin operacionale. Gjithashtu, përmirësimi i instrumenteve rregullatore do të ndihmojë shoqëritë për të përmirësuar menaxhimin e brendshëm të tyre me qëllim uljen e kostove të shërbimit dhe rritje e të ardhurave.

ERRU është e gatshme të bashkëpunojë me të gjithë aktorët në sektor për të gjetur zgjidhjet më të mira të mundshme për të pasur një sektor të qëndrueshëm financiarisht.

2.4. Performanca e sektorit UK

Bazuar në kompetencat që i jep ligji, ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme performancën e operatorëve që ofrojnë shërbime ujësjellës kanalizime dhe atë të sektorit në tërësi, rezultatet e të cilave botohen në Raportet e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime.

Nivelet aktuale të TPK-ve si dhe tendenca e tyre në tre vitet e fundit pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2. Treguesit kryesore të performancës^[1]

Nr	Treguesit	Njësia	2012	2013	2014	Tendenca
1	Mbulimi me Ujë	%	80.8	80.8	81	=
2	Mbulimi me Kanalizime	%	51.0	51	51	=
3	Mbulimi i Kostove O&M	%	106.3	113.8	114	↗
4	Mbulimi i Kostos Totale	%	82.7	84.6	85	↗
5	Norma e Arkëtimit	%	90.9	82	89.2	↗
6	Niveli i Matjes	%	55.1	59	60	↗
7	Ujë pa të Ardhura	%	67.1	67.4	67.4	=
8	Efiçenca e stafit (stafi/1000 lidhje)	nr	9.3	9.5	8.9	↗
9	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	ore/dite	10.8	11.5	11.5	=

Në vitin 2014, mbulimi me ujë dhe kanalizime, uji pa të ardhura dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë nuk kanë ndryshuar krahasuar me një vit më parë. Niveli i mbulimit të kostove O&M dhe kostove totale, niveli i matjes dhe efiçenca e stafit kanë pasur ndryshime të vogla pozitive krahasuar me vitin 2013.

^[1] TPK për vitin 2014 janë përlogaritur në bazë të të dhënave 6 mujore të marra nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking pranë DPUK.

Burimi kryesor i të ardhurave të shoqërive UK është **arkëtimi i të ardhurave** që realizohen nga shërbimi i furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura për konsumatorët në zonën e tyre të juridiksionit.

ERRU konstaton se përgjithësisht shoqëritë gjatë këtij viti kanë treguar më shumë vëmendje në drejtim të arkëtimit të të ardhurave krahasuar kjo me vitin e kaluar, niveli i këtij treguesi është rritur me rreth 7.2%. Norma e arkëtimit është direkt e lidhur me menaxhimin dhe niveli i arritur për këtë tregues shpreh qartë punën e vetë shoqërisë.

Megjithatë, shoqëritë UK duhet ti japin përparësi faturimit dhe arkëtimit në kohë, në mënyrë që qëndrueshmëria financiare të përmirësohet. Për shumë shoqëri arkëtimi i borxheve të këqija vazhdon të jetë problematik. Një ndikim pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi ka ofrimi i shërbimeve cilësore. Eksperiencat tregojnë se shoqëritë që ofrojnë shërbime cilësore kanë normë arkëtimi të lartë, konsumatorët nuk hezitojnë të paguajnë edhe nëse tarifat rriten.

Një tregues tjetër që shënon rritje gjatë viteve të fundit është **niveli i matjes**. Ky tregues i ndihmon operatorët të operojnë me të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e prodhuar, faturuar dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga ky faturim.

Për vitin 2014 niveli i shërbimit të matur në sektor ka arritur në rreth 60%. Krahasuar me vitin 2012, niveli i matjes në vitin 2014 është rritur me 5%.

Me gjithë përmirësimet në këtë drejtim, momentalisht niveli i faturimit afrofe për konsumatorët mbetet në nivele të larta. Shoqëritë deri në fund të vitit 2010 duhet të kishin përfunduar instalimin e matësive për gjithë klientët jo familjarë, por rezultatet tregojnë se në nivel sektori 23% e klientëve jo familjarë i përkasin ende shërbimit aforfe.

Për ERRU, eliminimi i kësaj praktike dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësive individual dhe në prodhim duhet të jetë në fokus të punës së operatorëve. Në sektor, një numër i kufizuar operatorësh kanë instaluar matësit për të gjithë klientët, pjesa më e madhe ofron shërbim të matur dhe të pamatur, por ka edhe shoqëri të cilat pothuajse nuk ofrojnë shërbim të matur për konsumatorët.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar situatën në lidhje me pajisjen me matës të konsumatorëve si dhe ka kërkuar që të përfundojë pajisja me matës e konsumatorëve jo familjarë si dhe të gjithë lidhjet e reja ti përkasin shërbimit të matur.

Uji pa të ardhura, është një tregues i cili të paktën në tre vitet e fundit mbetet në nivele aspak të mira dhe përben shqetësimin kryesor në sektor. Niveli i humbjeve në sektor është 67.4% e ujit të prodhuar. Kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, për rrjedhojë nuk gjeneron të ardhura.

Edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve kërkon kohe dhe investime, ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve.

ERRU vazhdimisht i ka sugjeruar shoqërive UK, hartimin e bilanceve të ujit si një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e ujit pa të ardhura. Në vitin 2013 rregullatori përgatiti Modelin e Bilancit të Ujit dhe kërkoj plotësimin e tij të detyrueshëm nga të gjitha shoqëritë. Analiza e humbjeve bazuar në Bilancin e ujit tregon se humbjet menaxheriale janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, pra përveçse një sistemi të amortizuar, niveli i lartë i humbjeve është rezultat i një menaxhimi jo të mirë të shoqërive.

Kjo situatë shtron para të gjithë shoqërive marrjen e masa urgjente duke filluar me evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme, rritjen e nivelit të faturimit dhe arkëtimit, vendosjen e matësave në prodhim, matësave të bilancit dhe ato në shpërndarje për të njohur situatën reale të humbjeve.

Reduktimin e ujit pa të ardhura, ERRU e ka parë gjithmonë si një nga treguesit kryesor për të pasur shoqëri të qëndrueshme financiarisht. Për këtë arsye rregullatori nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese afatgjatë mbështet shoqëritë në punën e tyre që kjo gjendje të ndryshojë sa më shpejt për këtë sektor.

Në vitin 2014, **efiçenca e stafit** është tregues i cili nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar, por tendenca është pozitive. Megjithatë ka edhe operatorë ku efiçenca e stafit është në nivele bashkëkohore

Numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje është ulur nga 9.5 në 8.9. Niveli i këtij treguesi është i lartë nëse do ta krahasojmë atë edhe me vendet e rajonit.

Ky tregues luan një rol të rëndësishëm në nivelin e shpenzimeve dhe kërkon më shumë vëmendje nga operatorët. Çelësi i suksesit për një performancë të mirë të këtij treguesi qëndron në optimizimin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar e të motivuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësisive dhe zgjerimin e bazës së klientëve.

Eksperiencat tregojnë se nivelet më të larta të efiçencës së stafit janë më të lehta për tu arritur nga shoqëritë e mëdha, që operojnë në zonat urbane ose me densitet të lartë të popullsisë.

ERRU ka vlerësuar performancën e operatoreve në lidhje me cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve mbi bazën e analizës dhe monitorimit të **vazhdimësisë së shërbimit si dhe cilësisë së ujit të pijshëm**.

Cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë të konsumatorëve nuk është në nivel të mirë dhe reflektohet në mos furnizimin e vazhdueshëm të klientëve me ujë të pijshëm dhe me presionin e duhur.

*Në vitin 2014 kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2013. Konsumatorët janë furnizuar me ujë **mesatarisht 11.5 orë në ditë**. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit.*

Shkalla e furnizimit me ujë edhe gjatë vitit 2014 varion nga 4 - 24 orë ujë në ditë. Operatorët që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur janë vetëm sh.a. UK Korçë, sh. a. UK Pogradec dhe sh. a. UK Librazhd. Pjesa më e madhe e operatorëve ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar.

ERRU edhe pse nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë një nga treguesit kryesorë për të përmbushur mandatin e tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. Janë dy parametra kryesorë që vlerësojnë sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm, zbatimi i standardeve bakteriologjike (koliformi) dhe të klorit mbetës.

ERRU gjithashtu kërkon që shoqëritë e licencuara të zbatojnë procedura të përshtatshme që konsumatorët të mbahen të informuar lidhur me cilësinë e furnizimit me ujë dhe riskun e ndotjes.

Shoqëritë, megjithë masat e marra për përmirësimin e cilësisë së ujit në piken e furnizimit, për shumë arsye të tjera si furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët për të kompensuar presionin e ulët të rrjetit, nuk garantojnë cilësinë e ujit tek konsumatorët. Kjo thekson ndërvarësinë e fushave të ndryshme të performancës së shoqërive për të siguruar ujë cilësisht të pastër.

Përsa i përket **ujërave të ndotura**, ende nuk mund të flasim për cilësi përderisa ato nuk trajtohen përpara shkarkimit. Aktualisht funksionojnë 5 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura. Shkarkimi i ujërave të ndotura nga sistemet e kanalizimeve pa u trajtuar krijon probleme mjedisore në zonën e tyre të shkarkimit. Por situata do të vijë duke u përmirësuar me vënien në funksionim të impianteve të tjerë, për të cilët ka përfunduar ndërtimi dhe së shpejti do të vihen në funksionim.

2.5. Objektivat rregullatore të sektorit UK për vitin 2015

Edhe për vitin 2015, objektivat e ERRU-së vazhdojnë të mbeten ambicioze dhe mbështesin ato objektiva të vendosura në strategjinë e qeverisë për sektorin UK.

Tabela 3. Treguesit e performancës për vitin 2015

Nr	Treguesit	Njësia	Objektivat e shoqërive në 2014	Objektivat e ERRU-së për 2015	Objektivat në Strategjinë e Sektorit për 2015
1	Mbulimi me Ujë	%	81	n/a	95/79 ⁴
2	Mbulimi me Kanalizime	%	51	75	86/25 ⁵
3	Mbulimi i Kostove O&M	%	114	>100	>100
4	Mbulimi i Kostos Totale	%	85	87	76
5	Norma e Arkëtimit	%	89.2	92	94
6	Niveli i Matjes	%	60	85	72
7	Ujë pa të Ardhura	%	67.4	48	48
8	Efiçenca e stafit (stafi/1000 lidhje)	nr	8.9	4/6/10	n/a
9	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	ore/dite	11.5	16	16
10	Mbulimi me shërbim të trajtuar	%	10	30	30

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij sektori si dhe të drejtën e çdo qytetari për të pasur shërbim të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, të gjitha institucionet përgjegjëse në përputhje me përgjegjësitë institucionale dhe ligjore që kanë, duhet të angazhohen maksimalisht në ecurinë e këtij sektori

Instrumenti rregullator i drejtpërdrejtë që ERRU përdor për të mbështetur realizimin e këtyre objektivave është vetëm politika tarifore.

Për të qenë me efektiv në realizimin e këtyre objektivave është e nevojshme që rregullatori të bashkëpunojë me politikë-bërësit që subvencionet dhe investimet në infrastrukture për sektorin UK të akordohen mbi kritere që shpërblejnë ata operatorë që arrijnë objektivat e vendosura.

Nga ana jonë, ERRU synon që me anë të politikës tarifore, të nxisë operatorët për të realizuar objektivat e mësipërme duke pasur parasysh:

- Planet e biznesit të drejtohen me investime në zonat e pambuluara me shërbime ujësjellës kanalizime;

⁴ Mbulueshmëria me ujë në zonën urbane / mbulueshmëria me ujë në zonën rurale

⁵ Mbulueshmëria me kanalizime në zonën urbane / mbulueshmëria me kanalizime në zonën rurale

- Vënien e objektivave më të larta për normën e arkëtimit, duke qenë se ky tregues është tërësisht i lidhur me menaxhimin e operatorit dhe shpreh qartë punën e vetë shoqërisë;
- Lehtësimi i procesit të arkëtimit ndihmohet nga rritja e nivelit të matjes së shërbimeve, sidomos për klientët familjare. Rezultatet tregojnë se akoma faturimi aforfe është në nivel të lartë, ndërkohë që ky proces duhet të ishte mbyllur me kohe. Gjithashtu, matja e shërbimit jo domosdoshmërisht nënkupton instalimin e pajisjeve nga më modernet, pasi kjo mund të çojë dhe në rritjen e kostove të pamundura për tu përballuar nga operatorët.
- Uljen e nivelit të ujit pa të ardhura që sipas analizave nga bilanci i ujit rezulton se gati gjysma përfaqëson humbje administrative. Analiza e bilancit të ujit është një domosdoshmëri për operatorët. Ato duhet të marrin masa urgjente duke filluar me vendosjen e matësave në prodhim dhe ato të bilancit, fillimisht për të njohur situatën reale të humbjeve. Gjithashtu dhe me evidentimin dhe eliminimin apo legalizimin e lidhjeve të paligjshme, qoftë në transmetim ashtu edhe në shpërndarje.
- Kombinimi dhe realizimi i objektivave të mësipërme, detyrimisht do të çojë në rritjen e vazhdueshmërisë së furnizimit me ujë dhe përmirësimin e cilësisë së ujit.
- Megjithë rritjen e performancës financiare të shoqërive UK të mesme dhe të mëdha, shoqëritë duhet të vazhdojnë të jenë të kujdesshme në kryerjen e analizës për kostot e shërbimeve që kryejnë. Përqindjen më të madhe në totalin e tyre e zënë kostot e personelit dhe energjisë elektrike, prandaj edhe përpjekjet e shoqërive duhet të përqendrohen për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve.

Raporti i ERRU-së për performancën e sektorit për vitin 2014, do të synojë një analizë individuale të operatorëve në lidhje me këto objektiva, duke u fokusuar në elementet problematike të tyre dhe sugjeruar zgjidhje të mundshme.

Aneksi 1 - Aplikimet për ndryshimin për tarifa në vitin 2014

Tabela 1 - Tarifat aktuale dhe të kërkuara për 11 operatore që kanë aplikuar gjatë 2014

Operatori	Shërbimi	Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale		Tarifat e kërkuara	
			fikse	variabël	fikse	variabël
			lek/klient/muaj	lek/m3	lek/klient/muaj	lek/m3
Sh.a UK Fier	ujë i pijshëm	Klientë familjare	200	52	220	57
		Klientë buxhetor	200	105	220	115
		Klientë privat	200	125	220	137
	ujë i ndotur	Klientë familjare		13		14
		Klientë buxhetor		18		20
		Klientë privat		20		22
Sh.a UK Gjirokastrë r Qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjare	80	39	84	41
		Klientë buxhetor	80	112	84	118
		Klientë privat	80	124	84	130
	ujë i ndotur	Klientë familjare		9		10
		Klientë buxhetor		14		15
		Klientë privat		14		15
Sh.a UK Lezhë	ujë i pijshëm	Klientë familjare	200	58	230	67
		Klientë buxhetor	200	135	230	155
		Klientë privat	200	145	230	167
	ujë i ndotur	Klientë familjare		18		21
		Klientë buxhetor		22		25
		Klientë privat		27		31
Sh.a UK Lushnje	ujë i pijshëm	Klientë familjare	100	54	100	60
		Klientë buxhetor	200	125	200	137
		Klientë privat	200	135	200	149
	ujë i ndotur	Klientë familjare		15		17
		Klientë buxhetor		20		22
		Klientë privat		22		24
Sh.a UK Sarandë	ujë i pijshëm	Klientë familjare	120	50	156	55
		Klientë buxhetor	120	135	156	149
		Klientë privat	120	135	156	149
	ujë i ndotur	Klientë familjare		18		21
		Klientë buxhetor		28		31
		Klientë privat		28		31
Sh.a UK Korçë	ujë i pijshëm	Klientë familjare	120	65	120	72
		Klientë buxhetor	120	110	150	115
		Klientë privat	120	140	150	140
	ujë i ndotur	Klientë familjare		34		40
		Klientë buxhetor		56		67
		Klientë privat		56		67
Sh.a U Elbasan fshat	ujë i pijshëm	Klientë familjare	100	36	200	84
		Klientë buxhetor	100	110	200	160
		Klientë privat	100	110	200	200

Operatori	Shërbimi	Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale		Tarifat e kërkuara	
			fikse	variabël	fikse	variabël
			lek/klient/muaj	lek/m3	lek/klient/muaj	lek/m3
Sh.a UK Krujë	ujë i pijshëm	Klientë familjare		33		50
		Klientë buxhetor		80		150
		Klientë privat		80		150
	ujë i ndotur	Klientë familjare		8		12
		Klientë buxhetor		12		15
		Klientë privat		12		15
Sh.a UK Ersekë	ujë i pijshëm	Klientë familjare	100	35	100	44
		Klientë buxhetor	100	90	100	112.5
		Klientë privat	100	110	100	137
	ujë i ndotur	Klientë familjare		8		10
		Klientë buxhetor		12		15
		Klientë privat		12		22.5
Sh.a U Poliçan	ujë i pijshëm	Klientë familjare		37		75
		Klientë buxhetor		80		133
		Klientë privat		95		133
Sh.a U Korçë fshat	ujë i pijshëm	Klientë familjare			100	50
		Klientë buxhetor			100	100
		Klientë privat			100	120

Tabela 2 - Kërkesa për tarife e Sh.a UK Himarë

Nr.	Emërtesa	lek/m3		lek/muaj		qershor-korrik-gusht	
		Ujë	Ujë i ndotur	Ujë	Ujë i ndotur	Ujë	Ujë i ndotur
A	Faturimi për klientët me matësa						
1	Familjare me ngritje mekanike	40	24				
2	Familjare me rrjedhje te lire	30	18				
3	Biznes i vogël me ngritje mekanike	80	50				
4	Biznes i vogël me rrjedhje te lire	60	40				
5	Biznes juridik me ngritje mekanike	120	70				
B	Faturimi Afrofe						
1	Familjare me ngritje mekanike			400	240		
2	Familjare me rrjedhje te lire			300	180		
3	Bufe restorante			700	420	1500	900
4	Byrek - Piceri- Furra			500	300	1000	600
5	Fabrike vaji dhe te tilla			2000	1200		
6	Pika beton, lavazho,biznese ndërtimi etj si këto			12000	7200	20000	12000
7	Hotele, motele dhoma plazhi për çdo dhome			200	120	600	360
8	Aktivitete si farmaci,berber,merkato etj.			300	180		
9	Institucione zyrtare si Banka, tekumunikacioni, ISKSH etj.			500	300		
10	Tarife për lidhje kontrate Familjare			8000			
11	Tarife për lidhje kontrate abonenti			1000			
12	Tarife për lidhje kontrate biznes i vogël			12000			
13	Tarife për lidhje kontrate biznes i madh			20000			
14	Tarife fikse familjare			100			
15	Tarife fikse biznes i vogël			200			
16	Tarife fikse biznes i madh			400			

Aneksi 2 - Tarifat aktuale për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujëra të ndotura

Lloji i shoqërisë	Emërtimi	Data e hyrjes në fuqi të	Për Ujin e pijshëm lek/m3			Tarife shërbimi lek/klient/muaj			Për Ujin e Ndotur lek/m3		
			F	B	P	F	B	P	F	B	P
Sha UK	Berat - Kuçovë	01/06/2014	44	125	125	100	200	200	12	20	20
Sha U	Bilisht (Devoll)	01/01/2012	38	100	110	50	50	50			
Sha U	Bulqizë	01/01/2013	17	55	75	100	100	100			
Sha U	Burrel (Mat)	01/01/2006	23	60	80				2	4	6
Sha UK	Delvinë	01/06/2008	48	100	100						
Sha UK	Durrës	01/06/2013	58	110	120	100	100	100	35	50	50
Sha UK	Elbasan (Elber)	01/01/2006	38	115	130				8	25	30
Sha U	Elbasan Fshat	01/01/2013	36	110	110	100	100	100			
Sha U	Ersekë	01/01/2014	35	90	110	100	100	100	8	12	18
Sha UK	Fier	01/05/2014	52	105	125	200	200	200	13	18	20
Sha UK	Fushë Krujë	01/03/2005	28	60	80				6	10	12
Sha UK	Gjirokastrë	01/01/2014	39	112	124	80	80	80	9	14	14
Sha U	Gjirokastrë Fshat	01/07/2010	25	60	60						
Sha U	Gramsh	01/01/2011	32	90	90						
Sha UK	Kavajë	01/07/2010	38	80	100				15	20	20
Sha UK	Korçë	01/01/2014	65	110	140	120	120	120	34	56	56
Sha U	Krastë	01/07/2007	30	80	100				7	10	15
Sha UK	Krujë	01/06/2007	33	80	80				8	12	12
Sha U	Kukës	01/10/2004	25	60	80				7	15	20
Sha U	Kurbini	01/01/2011	30	80	120	50	50	50			
Sha UK	Lezhë	01/01/2014	58	135	145	200	200	200	18	22	27
Sha UK	Librazhd	01/03/2012	38	100	100				13	22	23
Sha UK	Lushnjë	01/04/2014	54	125	135	100	200	200	15	20	22
Sha U	Lushnjë Fshat	01/01/2006	60	70	100						
Sha UK	Mirditë (Rrëshen)	01/01/2012	30	100	115				10	15	15
Sha U	Novoselë	01/01/2012	33	50	70						
Sha U	Orikum	01/01/2011	25	70	75	100	100	100			
Sha UK	Peqin	01/07/2010	30	90	100	50	50	50			
Sha U	Përmet	01/01/2013	40	110	120	100	100	200			
Sha U	Peshkopi	1/1/2010 dhe 01/07/2014	27	65	85				10	15	18
Sha UK	Pogradec	01/01/2013	22/62	37/111	37/111	200+100	400+100	400+150	11./33	12./36	12./36
Sha U	Poliçan	01/07/2010	37	80	95						
Sha UK	Pukë	01/01/2014	35	130	140			100	8	16	16
Sha UK	Rrogozhinë	01/01/2013	48	90	100	50	100	100	10	12	12
Sha UK	Rubik	01/10/2008	30	70	100				7	10	15
Sha UK	Sarandë	01/01/2014	50	135	135	120	120	120	18	28	28
Sha U	Selenicë	01/07/2010	30	80	100						
Sha UK	Shkodër	01/01/2012	40	110	110	100	100	100	15	20	20
Sha U	Shkodër Fshat	01/01/2012	50	120	120						
Sha U	Skrapar - Çorovodë	01/03/2010	27	80	95						
Sha U	Tepelenë	01/01/2014	33	100	120	90	400	250	12	20	20
Sha UK	Tiranë	01/01/2012	45	120	135	100	100	100	11	30	35
Sha U	Tropojë	01/11/2004	19	60	80						
Sha U	Ura Vajgurore	10/01/2007	40	90	100						
Sha U	Vlorë	01/05/2013	30	60	80				11	13	13

Shënim: F -Klientë Familjar, B -Klientë Buxhetor, P -Klientë Privat

Aneksi 3 - Realizimi i TKP për vitin 2014

Nr.	INDIKATORËT	Sarandë UK Sh.A		Berat_Kuqovë UK Sh.A		Lezhë UK Sh.A		Korçë UK Sh.A	
		Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi
1	Uji pa te ardhura (%)	70	72.9	70	84.7	47	48.5	24	24.5
2	Niveli i matjes (%)	70	65.5	53	41.8	75	61.8	100	100.0
3	Kohëzgjatja e furnizimit (ore/dite)	6	4.5	11	9.5	20	20.0	24	24.0
4	Efienca e energjisë (kwh/m3)	0.72	0.8	1.83	1.8	2.5	2.5	0.78	0.7
5	Efikasiteti i stafit (staf/1000 lidhje)	3.6	3.4	5.3	5.5	6	5.2	2.29	2.5
6	Mbulimi me ujë (%)	100	100.0	90	90.6	90	90.7	100	100.0
7	Mbulimi me kanalizime (%)	94	75.0	75	74.81	90.0	90.72	94.0	95.37
8	Norma e arkëtimit (%)	75	61.7	85	69.6	85	72.7	91	87.4
9	Cilësia e ujit (standartet) (%)	100		100		100		100	

Nr	INDIKATORËT	Fier UK Sh.A		Gjirokastër (Q) UK Sh.A		Lushnje UK (Q) Sh. A		Ersekë UK Sh.A		Bashkia Pukë UK	
		Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi	Objektivi	Realizimi
1	Uji pa te ardhura (%)	60	60.4	65	73.2	65	75.6	62	65.9	66	57.1
2	Niveli i matjes (%)	60	54.7	15	0.8	99	76.9	75	66.2	70	46.6
3	Kohëzgjatja e furnizimit (ore/dite)	22	20.2	5	4.0	8	4.7	16	23.2	10	18.0
4	Efienca e energjisë (kwh/m3)	0.78	1.0	0.8	0.5	0.58	0.6	2.6	0.0		0.0
5	Efikasiteti i stafit (staf/1000 lidhje)	4.4	7.0	6	7.8	5.9	5.9	5.5	5.9	10	9.3
6	Mbulimi me ujë (%)	96	98.0	92	93.5	85	65.9	100	100.0	60	54.3
7	Mbulimi me kanalizime (%)	62.0	62.41	50.0	38.99	70.0	50.23	100.0	100	54.0	39.63
8	Norma e arkëtimit (%)	75	74.8	91	90.0	85	86.0	92	104.1	85	106.8
9	Cilësia e ujit (standartet) (%)	100		100		100		100		100	

Aneksi 4 - Lista ekzistuese e njësive brenda dhe jashtë zonës së juridiksionit të shoqërive UK

RRETHI	Nr.	KOMUNA	SHOQËRIA U-K
Rrethi i Beratit	1	Bashkia Berat	Sh.a UK Berat-Kuçovë
	2	Bashkia Ura Vajgurore	Sh.a U Ura Vajgurore
	3	Komuna Otlak	Sh.a UK Berat-Kuçovë
	4	Komuna Poshnje	Sh.a U Ura Vajgurore (pjes.) & Sh.a U Lushnje Fshat (pjes.)
	5	Komuna Vërtop	Sh.a UK Berat-Kuçovë
	6	Komuna Cukalat	
	7	Komuna Kutalli	
	8	Komuna Lumas	
	9	Komuna Roshnik	
	10	Komuna Sinjë	
	11	Komuna Tërpan	
	12	Komuna Velabisht	
Rrethi i Kuçovës	13	Bashkia Kuçovë	Sh.a UK Berat-Kuçovë
	14	Komuna Kozare	Sh.a UK Berat-Kuçovë
	15	Komuna Perondi	Sh.a UK Berat-Kuçovë
Rrethi i Skraparit	16	Bashkia Çorovodë	Sh.a U Skrapar
	17	Bashkia Poliçan	Poliçan
	18	Komuna Bogovë	Sh.a U Poliçan (pjes.) & Sh.a U Skrapar (pjes.)
	19	Komuna Çepan	Sh.a U Skrapar
	20	Komuna Gjerbës	Sh.a U Skrapar
	21	Komuna Potom	Sh.a U Skrapar
	22	Komuna Qendër	Sh.a U Skrapar
	23	Komuna Vendreshë	Sh.a U Skrapar
	24	Komuna Zhepë	Sh.a U Skrapar
	25	Komuna Leshnjë	
Rrethi i Bulqizës	26	Bashkia Bulqizë	Sh.a U Bulqizë
	27	Komuna Shupenzë	Sh.a U Bulqizë
	28	Komuna Martanesh	Sh.a UK Krastë
	29	Komuna Fushë-Bulqizë	
	30	Komuna Gjoricë	
	31	Komuna Ostren	
	32	Komuna Trebisht	
	33	Komuna Zerqan	
Rrethi i Dibrës	34	Bashkia Peshkopi	Sh.a UK Peshkopi
	35	Komuna Fushë-Çidhën	Sh.a UK Peshkopi
	36	Komuna Kala e Dodës	Sh.a UK Peshkopi
	37	Komuna Kastriot	Sh.a UK Peshkopi
	38	Komuna Luzni	Sh.a UK Peshkopi
	39	Komuna Tomin	Sh.a UK Peshkopi
	40	Komuna Sllovë	Sh.a UK Peshkopi
	41	Komuna Arras	
	42	Komuna Lurë	
	43	Komuna Maqellarë	
	44	Komuna Melan	
	45	Komuna Muhur	
	46	Komuna Selishtë	
	47	Komuna Zall-Dardhë	
	48	Komuna Zall-Reç	

RRETHI	Nr.	KOMUNA	SHOQËRIA U-K
Rrethi i Matit	49	Bashkia Burrel	Sh.a UK Mat
	50	Komuna Lis	Sh.a UK Mat
	51	Bashkia Klos	
	52	Komuna Baz	
	53	Komuna Derjan	
	54	Komuna Gurrë	
	55	Komuna Komsî	
	56	Komuna Macukull	
	57	Komuna Rukaj	
	58	Komuna Suç	
	59	Komuna Ulëz	
60	Komuna Xibër		
Rrethi i Durrësit	61	Bashkia Durrës	Sh.a UK Durrës
	62	Bashkia Manzë	Sh.a UK Durrës
	63	Bashkia Sukth	Sh.a UK Durrës
	64	Bashkia Shijak	Sh.a UK Durrës
	65	Komuna Gjepalaj	Sh.a UK Durrës
	66	Komuna Ishëm	Sh.a UK Durrës
	67	Komuna Katund i Ri	Sh.a UK Durrës
	68	Komuna Maminas	Sh.a UK Durrës
	69	Komuna Rrashbull	Sh.a UK Durrës
	70	Komuna Xhafzotaj	Sh.a UK Durrës
	71	Komuna Bubqi	Sh.a UK Durres
Rrethi i Krujës	72	Komuna Thumanë	Sh.a UK Durres
	73	Bashkia Fushë-Krujë	Sh.a UK Fushë -Krujë
	74	Bashkia Krujë	Sh.a UK Kruje
	75	Komuna Çudhiu	Sh.a UK Kruje
	76	Komuna Nikël	
Rrethi i Elbasanit	77	Bashkia Elbasan	Sh.a UK Elbasan
	78	Bashkia Belsh	Sh.a U Elbasan fshat
	79	Bashkia Cërrik	Sh.a U Elbasan fshat
	80	Komuna Fierzë	Sh.a U Elbasan fshat
	81	Komuna Gjergjan	Sh.a U Elbasan fshat
	82	Komuna Gjinar	Sh.a U Elbasan fshat
	83	Komuna Gostimë	Sh.a U Elbasan fshat
	84	Komuna Graçen	Sh.a U Elbasan fshat
	85	Komuna Grekan	Sh.a U Elbasan fshat
	86	Komuna Kajan	Sh.a U Elbasan fshat
	87	Komuna Labinot-Fushë	Sh.a U Elbasan fshat
	88	Komuna Labinot-Mal	Sh.a U Elbasan fshat
	89	Komuna Mollas	Sh.a U Elbasan fshat
	90	Komuna Papër	Sh.a U Elbasan fshat
	91	Komuna Rrasë	Sh.a U Elbasan fshat
	92	Komuna Shalës	Sh.a U Elbasan fshat
	93	Komuna Shirgjan	Sh.a U Elbasan fshat
	94	Komuna Shushicë	Sh.a U Elbasan fshat
	95	Komuna Tregan	Sh.a U Elbasan fshat
	96	Komuna Zavalinë	Sh.a U Elbasan fshat
	97	Komuna Bradashesh	Komuna Bradashesh
	98	Komuna Funar	
	99	Komuna Klos	

RRETHI	Nr.	KOMUNA	SHOQËRIA U-K
Rrethi i Gramshit	100	Bashkia Gramsh	Sh.a U Gramsh
	101	Komuna Kodovjat	Sh.a U Gramsh
	102	Komuna Kushovë	Sh.a U Gramsh
	103	Komuna Pishaj	Sh.a U Gramsh
	104	Komuna Sult	Sh.a U Gramsh
	105	Komuna Tunjë	Sh.a U Gramsh
	106	Komuna Kukur	
	107	Komuna Poroçan	
	108	Komuna Shënepremte	
	109	Komuna Skënderbegas	
Rrethi i Librazhdit	110	Bashkia Librazhd	Sh.a UK Librazhd
	111	Bashkia Prenjas	Sh.a UK Librazhd
	112	Komuna Rrajcë	Sh.a UK Librazhd
	113	Komuna Qendër	Sh.a UK Librazhd
	114	Komuna Stravaj	
	115	Komuna Steblevë	
	116	Komuna Qukës	
	117	Komuna Polis	
	118	Komuna Orenjë	
	119	Komuna Lunik	
	120	Komuna Hotolisht	
Rrethi i Peqinit	121	Bashkia Peqin	Sh.a U Peqin
	122	Komuna Shezë	Sh.a U Peqin
	123	Komuna Përparim	
	124	Komuna Pajovë	
	125	Komuna Karinë	
	126	Komuna Gjoçaj	
Rrethi i Fierit	127	Bashkia Fier	Sh.a UK Fier
	128	Komuna Dermenas	Sh.a UK Fier
	129	Komuna Frakull	Sh.a UK Fier
	130	Komuna Kuman	Sh.a UK Fier
	131	Komuna Levan	Sh.a UK Fier
	132	Bashkia Roskovec	Sh.a UK Fier
	133	Komuna Qendër	Sh.a UK Fier
	134	Komuna Topojë	Sh.a UK Fier
	135	Bashkia Patos	Sh.a U Patos
	136	Komuna Cakran	Sh.a U Patos
	137	Komuna Portëz	Sh.a U Patos
	138	Komuna Libofshë	Sh.a U Lushnje Fshat
	139	Komuna Zharrëz	
	140	Komuna Kurjan	
	141	Komuna Mbrostar	
	142	Komuna Ruzhdije	
	143	Komuna Strum	
Rrethi i Lushnjës	144	Bashkia Divjakë	Sh.a U Divjakë
	145	Bashkia Lushnje	Sh.a UK Lushnje
	146	Komuna Allkaj	Sh.a U Lushnje Fshat
	147	Komuna Bubullimë	Sh.a U Lushnje Fshat
	148	Komuna Dushk	Sh.a U Lushnje Fshat (Pjes.) & UK Lushnje (Pjes.) Sh.a
	149	Komuna Fier-Shegan	Sh.a U Lushnje Fshat
	150	Komuna Gradishtë	Sh.a U Lushnje Fshat
	151	Komuna Kolonjë	Sh.a U Lushnje Fshat
	152	Komuna Krutje	Sh.a U Lushnje Fshat
	153	Komuna Remas	Sh.a U Lushnje Fshat
	154	Komuna Tërbuf	Sh.a U Lushnje Fshat
	155	Komuna Ballagat	
	156	Komuna Golem	
	157	Komuna Grabian	
	158	Komuna Hysgjokaj	
	159	Komuna Karbunarë	

RRETHI	Nr.	KOMUNA	SHOQËRIA U-K
Rrethi i Mallakastrës	160	Bashkia Ballsh	Sh.a UK Mallakastër
	161	Komuna Aranitas	Sh.a UK Mallakastër
	162	Komuna Fratar	Sh.a UK Mallakastër
	163	Komuna Hekal	Sh.a UK Mallakastër
	164	Komuna Kutë	Sh.a UK Mallakastër
	165	Komuna Qendër	Sh.a UK Mallakastër
	166	Komuna Greshicë	
	167	Komuna Ngraçan	
	168	Komuna Selitë	
Rrethi i Gjirokastrës	169	Bashkia Gjirokastrë	Sh.a UK Gjirokastrë
	170	Bashkia Libohovë	Sh.a U Libohovë
	171	Komuna Antigonë	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	172	Komuna Cepo	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	173	Komuna Dropull i Poshtëm	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	174	Komuna Dropull i Sipërm	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	175	Komuna Lazarat	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	176	Komuna Lunxhër	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat (pjes.)
	177	Komuna Odrie	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	178	Komuna Picar	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	179	Komuna Qendër Libohovë	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	180	Komuna Zagorie	Ndërmarrje U Gjirokastrë Fshat
	181	Komuna Pogon	
Rrethi i Përmetit	182	Bashkia Përmet	Sh.a U Përmet
	183	Komuna Petran	Sh.a U Përmet
	184	Bashkia Këlcyrë	Sh.a U Këlcyrë
	185	Komuna Sukë	
	186	Komuna Ballaban	
	187	Komuna Çarshovë	
	188	Komuna Piskovë	
	189	Komuna Frashër	
	190	Komuna Dishnicë	
Rrethi i Tepelenës	191	Bashkia Tepelenë	Sh.a UK Tepelenë
	192	Bashkia Memaliaj	Sh.a UK Tepelenë
	193	Komuna Buz	Sh.a UK Tepelenë
	194	Komuna Memaliaj Fshat /QendërMemaliaj	Sh.a UK Tepelenë
	195	Komuna Krahës	Sh.a UK Tepelenë
	196	Komuna Kurvelesh	Sh.a UK Tepelenë
	197	Komuna Lopës	Sh.a UK Tepelenë
	198	Komuna Luftinjë	Sh.a UK Tepelenë
	199	Komuna Qendër Tepelenë	Sh.a UK Tepelenë
	200	Komuna Qesarat	Sh.a UK Tepelene
Rrethi i Devollit	201	Bashkia Bilisht	Sh.a U Bilisht
	202	Komuna Progër	Sh.a U Korçë Fshat
	203	Komuna Hoçisht	
	204	Komuna Miras	
	205	Komuna Qendër Bilisht	
Rrethi i Kolonjës	206	Bashkia Ersekë	Sh.a UK Ersekë
	207	Bashkia Leskovik	
	208	Komuna Barmash	
	209	Komuna Çlirim	
	210	Komuna Mollas	
	211	Komuna Novoselë	
	212	Komuna Qendër Leskovik	
213	Komuna Qendër Ersekë		

RRETHI	Nr.	KOMUNA	SHOQËRIA U-K
Rrethi i Korçës	214	Bashkia Korçë	Sh. a UK Korçë
	215	Bashkia Maliq	Sh.a U Korçë Fshat
	216	Komuna Drenovë	Sh.a U Korçë Fshat
	217	Komuna Libonik	Sh.a U Korçë Fshat
	218	Komuna Mollaj	Sh.a U Korçë Fshat
	219	Komuna Pojan	Sh.a U Korçë Fshat
	220	Komuna Qendër Bulgarec	Sh.a U Korçë Fshat
	221	Komuna Vithkuq	Sh.a U Korçë Fshat
	222	Komuna Voskop	Sh.a U Korçë Fshat
	223	Komuna Vreshtas	Sh.a U Korçë Fshat
	224	Komuna Gorë	
	225	Komuna Lekas	
	226	Komuna Liqenas	
	227	Komuna Moglicë	
	228	Komuna Pirg	
229	Komuna Voskopoje		
Rrethi i Pogradecit	230	Bashkia Pogradec	Sh.a UK Pogradec
	231	Komuna Buçimas	Sh.a UK Pogradec
	232	Komuna Çërravë	
	233	Komuna Dardhas	
	234	Komuna Udënisht	
	235	Komuna Proptisht	
	236	Komuna Trebinjë	
	237	Komuna Velçan	
Rrethi i Hasit	238	Bashkia Krumë	Sh.a U Has
	239	Komuna Fajzë	Sh.a U Has
	240	Komuna Gjinaj	Sh.a U Has
	241	Komuna Golaj	
Rrethi i Kukësit	242	Bashkia Kukës	Sh.a UK Kukës
	243	Komuna Bicaj	Sh.a UK Kukës
	244	Komuna Shtiqën	Sh.a UK Kukës
	245	Komuna Arrën	
	246	Komuna Bushtricë	
	247	Komuna Grykë-Çajë	
	248	Komuna Kalis	
	249	Komuna Kolsh	
	250	Komuna Malzi	
	251	Komuna Shishtavec	
	252	Komuna Surroj	
253	Komuna Terthorë		
254	Komuna Topojan		
255	Komuna Ujmisht		
256	Komuna Zapod		
Rrethi i Tropojës	257	Bashkia Bajram Curr	Sh.a U Tropojë
	258	Komuna Bujan	Sh.a U Tropojë
	259	Komuna Bytyç	Sh.a U Tropojë
	260	Komuna Fierzë	Sh.a U Tropojë
	261	Komuna Llugaj	Sh.a U Tropojë
	262	Komuna Margegaj	Sh.a U Tropojë
	263	Komuna Tropojë	Sh.a U Tropojë
	264	Komuna Lekbibaj	
Rrethi i Kurbinit	265	Bashkia Laç	Sh.a U Kurbin
	266	Bashkia Mamurras	Sh.a U Kurbin
	267	Komuna Milot	Sh.a U Kurbin
	268	Komuna Fushë-Kuqë	Sh.a UK Durrës

RRETHI	Nr.	KOMUNA	SHOQËRIA U-K
Rrethi i Lezhës	269	Bashkia Lezhë	Sh.a UK Lezhë
	270	Komuna Ball dren i Ri	Sh.a UK Lezhë
	271	Komuna Shëngjin	Sh.a UK Lezhë
	272	Komuna Blinisht	
	273	Komuna Dajç	
	274	Komuna Kallmet	
	275	Komuna Kolsh	
	276	Komuna Shënkoll	
	277	Komuna Ungrej	
278	Komuna Zejmen		
Rrethi i Mirditës	279	Bashkia Rrëshen	Sh.a UK Mirditë
	280	Komuna Fan	Sh.a UK Mirditë
	281	Komuna Orosh	Sh.a UK Mirditë
	282	Komuna Selitë	Sh.a UK Mirditë
	283	Bashkia Rubik	Sh.a UK Rubik
	284	Komuna Kaçinar	
	285	Komuna Kthellë	
Rrethi i Pukës	286	Bashkia Fushë-Arrëzë	Sh.a UK Fushë -Arrëz
	287	Bashkia Pukë	Sh.a UK Bashkia Pukë
	288	Komuna Qelëz	Sh.a U Pukë Fshat
	289	Komuna Qerret	Sh.a U Pukë Fshat
	290	Komuna Gjegjan	Sh.a U Pukë Fshat
	291	Komuna Fierzë	Sh.a U Pukë Fshat
	292	Komuna Iballë	Sh.a U Pukë Fshat
	293	Komuna Blerim	Sh.a U Pukë Fshat
	294	Komuna Qafë-Mali	Sh.a U Pukë Fshat
	295	Komuna Rrapë	Sh.a U Pukë Fshat
Rrethi i Shkodrës	296	Bashkia Vau i Dejës	U Vau Dejës shpk
	297	Bashkia Shkodër	Sh.a UK Shkodër
	298	Komuna Ana-Malit	Sh.a UK Shkodër Fshat
	299	Komuna Bërdicë	Sh.a UK Shkodër Fshat
	300	Komuna Dajç	Sh.a UK Shkodër Fshat
	301	Komuna Guri i Zi	Sh.a UK Shkodër Fshat
	302	Komuna Hajmel	Sh.a UK Shkodër Fshat
	303	Komuna Postribë	Sh.a UK Shkodër Fshat
	304	Komuna Rrethinat	Sh.a UK Shkodër Fshat
	305	Komuna Shalë	Sh.a UK Shkodër Fshat
	306	Komuna Shllak	Sh.a UK Shkodër Fshat
	307	Komuna Shosh	Sh.a UK Shkodër Fshat
	308	Komuna Velipojë	Sh.a UK Shkodër Fshat
	309	Komuna Vig-Mnelë	Sh.a UK Shkodër Fshat
	310	Komuna Bushat	
311	Komuna Pult		
312	Komuna Temal		
Rrethi i Malësisë së Madhe	313	Bashkia Koplík	Sh.a UK Shkodër Fshat
	314	Komuna Gruemirë	Sh.a UK Shkodër Fshat
	315	Komuna Kastrat	Sh.a UK Shkodër Fshat
	316	Komuna Kelmend	Sh.a UK Shkodër Fshat
	317	Komuna Qendër	Sh.a UK Shkodër Fshat
	318	Komuna Shkrel	Sh.a UK Shkodër Fshat
Rrethi i Kavajës	319	Bashkia Kavajë	Sh.a UK Kavajë
	320	Komuna Golem	Sh.a UK Kavajë
	321	Komuna Helmës	Sh.a UK Kavajë
	322	Komuna Lekaj	Sh.a UK Kavajë
	323	Komuna Luz i Vogël	Sh.a UK Kavajë
	324	Komuna Synej	Sh.a UK Kavajë
	325	Komuna Kryevidh	Sh.a UK Kavajë/ Sh.a UK Rrogozhinë
	326	Komuna Gosë	Sh.a UK Rrogozhinë
	327	Komuna Sinaballaj	Sh.a UK Rrogozhinë
	328	Bashkia Rrogozhinë	Sh.a UK Rrogozhinë

RRETHI	Nr.	KOMUNA	SHOQËRIA U-K	
Rrethi i Tiranës	329	Bashkia Tiranë	Sh.a UK Tiranë	
	330	Bashkia Kamëz	Sh.a UK Tiranë	
	331	Bashkia Vorë	Sh.a UK Durrës / Sh.a UK Tiranë	
	332	Komuna Baldushk	Sh.a UK Tiranë	
	333	Komuna Bërzhitë	Sh.a UK Tiranë	
	334	Komuna Bërzhitë	Sh.a UK Tiranë	
	335	Komuna Dajt	Sh.a UK Tiranë	
	336	Komuna Farkë	Sh.a UK Tiranë	
	337	Komuna Kashar	Sh.a UK Tiranë	
	338	Komuna Krrabë	Sh.a UK Tiranë	
	339	Komuna Paskuqan	Sh.a UK Tiranë	
	340	Komuna Petrelë	Sh.a UK Tiranë	
	341	Komuna Prezë	Sh.a UK Durrës & Sh.a UK Tiranë	
	342	Komuna Shëngjergj	Sh.a UK Tiranë	
	343	Komuna Vaqarr	Sh.a UK Tiranë	
	344	Komuna Zall-Herr	Sh.a UK Tiranë	
		345	Komuna Ndroq	
	346	Komuna Pezë		
	347	Komuna Zall-Bastar		
Rrethi i Delvinës	348	Bashkia Delvinë	Sh.a UK Delvinë	
	349	Komuna Finiq	Sh.a UK Sarandë	
	350	Komuna Mesopotam	Sh.a UK Delvinë & Sh.a UK Sarandë Pjes.	
	351	Komuna Vergo		
Rrethi Sarandë	352	Bashkia Sarandë	Sh.a UK Sarandë	
	353	Komuna Aliko	Sh.a UK Sarandë	
	354	Komuna Dhivër	Sh.a UK Sarandë	
	355	Komuna Ksamil		
	356	Komuna Livadhja		
	357	Komuna Lukovë		
	358	Komuna Markat		
	359	Komuna Xarrë		
	360	Bashkia Konispol		
Rrethi i Vlorës	361	Bashkia Vlorë	Sh.a UK Vlorë	
	362	Komuna Armen	Sh.a UK Vlorë	
	363	Komuna Kotë	Sh.a UK Vlorë	
	364	Komuna Qendër	Sh.a UK Vlorë	
	365	Komuna Shushicë	Sh.a UK Vlorë	
	366	Bashkia Himarë	Sh.a UK Himarë	
	367	Bashkia Orikum	Sh.a U Orikum	
	368	Bashkia Selenicë	Sh.a U Selenicë	
	369	Komuna Novoselë	Sh.a U Novoselë	
		370	Komuna Brataj	
		371	Komuna Horë-Vranisht	
		372	Komuna Sevaster	
		373	Komuna Vllahinë	

Shënim: Me ngjyrë të kuqe janë njësitë jashtë juridiksionit të shoqërive UK